

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8099
E shtunë, 19 korrik 2025
Çmimi 0.50 €

Gjykata në Hagë,
gjykatë paralele
serbe për Kosovën

FAQE 10



Shkruan: Kudus LAMA

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

NGA FISKALIZIMI TEK URAT: VENDIMET E QEVERISË NË DETYRË VIHEN NË PIKËPYETJE

FAQE 4-5



Qeveria në detyrë e Kosovës ka miratuar rreth 12 vendime pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit. Ministrat në detyrë kanë miratuar edhe udhëzime administrative, në mesin e tyre atë për përdorimin e pajisjeve

fiskale elektronike, të cilin Gjykata Supreme e ka shpallur të paligjshëm. Shumica e ministrave në qeverinë në detyrë janë edhe deputetë të Kuvendit, i cili nuk është konstituuar ende për shkak të mosmarrëveshjeve politike midis partive

parlamentare. Lidhur me këto vendime ekspertët e drejtësisë kanë vlerësuar se vendimi i Supremes e ka bërë të qartë se qeveria në detyrë ka shkelur Kushtetutën dhe ligjet, duke i lënë deputetët ta kryejnë edhe funksionin e ministrave

**'JORELAVANT',
'MASHTRUESE'
- MARRËVESHJA
E UASHINGTONIT
PËRPLAS OSMANIN
DHE HOTIN** F. 6



**RRËZIMI I
MOCIONIT NDAJ
LIDERËVE TË
UÇK-së, GUCATI:
ATA S'MËRZITEN,
JANË TË BINDUR
SE DO TË DALIN
FITIMTARË** F. 3



**ISMAILI DHE BALZI DISKUTOJNË
PËR BASHKËPUNIMIN NË MES TË
BQK-SË DHE BUNDESBANKËS** F. 8

SPORT



**LLAPI PARAQET FUTBOLLISTIN NGA
BOSNJË-HERCEGOVINA, ENEDIN MULALIO** F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVIÇË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja arrin pajtueshmëri për paketën e re të sanksioneve kundër Rusisë

BRUKSEL, 18 KORRIK - Vendet e Bashkimit Evropian (BE) janë pajtuar të premten për miratimin e një pakete të re sanksionesh kundër Rusisë për shkak të luftës së saj në Ukrainë si dhe për uljen e çmimit tavan për eksportet e naftës ruse. Paketa e 18 e ndëshkimeve ekonomike ndaj Rusisë prej se ajo e ka nisur pushtimin e Ukrainës më 2022 është miratuar pasi Sllovakia ka hequr dorë nga kundërshtimi disajavor, pas bisedimeve me Brukselin lidhur me planet për t'i hequr gradualisht importet e gazit rus. "BE-ja sapo miratoi një nga paketat më të forta të sanksioneve kundër Rusisë deri më tani. Çdo sanksion dobëson aftësinë e Rusisë për të bërë luftë. Mesazhi është i qartë: Evropa nuk do të tërhiqet nga mbështetja për Ukrainën. BE-ja do të vazhdojë ta rrisë presionin derisa Rusia ta ndalojë luftën",

ka thënë shefja e politikës së jashtme të BE-së, Kaja Kallas. Ndërsa kryeministri i Sllovakisë, Robert Fico, i njohur për qëndrimet e tij proruse, ka hequr dorë nga kundërshtimi pasi ka marrë "garancitë" e kërkuara nga Brukseli në lidhje me çmimet e gazit, ndërkohë që blloku synon t'i ndërpresë plotësisht importet ruse deri në fund të vitit 2027. Si pjesë e sanksioneve të reja që synojnë t'i dobësojnë financimet për luftën e Rusisë, diplomatët thanë se BE-ja është pajtuar ta ulë çmimin tavan për naftën ruse të eksportuar në vendet e treta 15 për qind nën vlerën e tregut. Kjo do të ndodhë pavarësisht se aleatët e BE-së nuk kanë arritur ta bindin presidentin amerikan, Donald Trump, ta mbështesë planin. Tavani i çmimit është një nismë e G7-s që synon ta kufizojë shumën e parave që Rusia fiton



nga eksporti i naftës në vende si Kina dhe India. Çmimi tavan për naftën, i vendosur në 60 dollarë nga G7 në vitin 2022, synon ta kufizojë çmimin me të cilin Moska mund të shesë naftë nëpër botë, duke ua ndaluar

kompanive të transportit dhe atyre të sigurimeve që të merren me eksportet ruse mbi këtë shumë. Sipas skemës së re të BE-së - që pritet të mbështetet nga aleatët të G7-s si Britania dhe Kanadaja - niveli i ri do të nisë me 47.6 dollarë dhe

mund të rregullohet në të ardhmen në përputhje me ndryshimet në çmimet e naftës. Gjithashtu, zyrtarët evropianë kanë thënë se BE-ja do të vendosë në listën e zezë mbi 100 anije të tjera të ashtuquajturës "flotë në hije", që janë cisterna të vjetra të përdorura nga Rusia për t'i anashkaluar kufizimet për eksportin e naftës. Po ashtu, parashikohen masa për t'ua pamundësuar tubacioneve të gazit në Detin Baltik, Nord Stream 1 dhe 2, të bëhen sërish në punë. Sanksione do të vendosen edhe ndaj një rafinerie naftë në Indi që është në pronësi ruse dhe ndaj dy bankave kineze, pasi BE-ja po përpaket t'i kufizojë lidhjet e Moskës me partnerët ndërkombëtarë. Sanksionet e reja pritet të miratohen zyrtarisht nga ministrat e BE-së më vonë gjatë ditës së premte.

Plani i Trumpit për shkurtrimin e ndihmave amerikane në botë e merr aprovimin final

WASHINGTON, 18 KORRIK - Dhoma e Përfaqësuesve e ka miratuar përfundimisht kërkesën e presidentit Donald Trump për t'i tërhequr rreth 9 miliardë dollarë nga fondet për ndihmat amerikane në botë dhe për transmetuesit publikë. Paketa për shkurtime financiare ka kaluar me 216 vota për dhe 213 kundër dhe tani do t'i dërgohet presidentit Trump për t'u nënshkruar në ligj. Votimi në Dhomën e Përfaqësuesve ka ardhur pasi paketa është ndryshuar këtë javë nga Senati për t'i përjashtuar shkurtime prej rreth 400 milionë dollarësh për programin global për luftën kundër HIV/AIDS-it, PEPFAR. Kjo ishte hera e parë pas dekadash që një president ka arritur me sukses të paraqesë një kërkesë për anulim fondesh dhe Shtëpia e Bardhë la të kuptohej se nuk do të jetë as e fundit. Disa republikanë janë



ndierë të shqetësuar për shkurtime, por gjithsesi i kanë mbështetur ato, duke mos dashur ta zemërojnë Trumpin e

as ta kundërshtojnë agjendën e tij. "Duhet të rikthehemi te sensi fiskal dhe ky është një hap i rëndësishëm", ka thënë

kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve, Mike Johnson, R-La. Kundërshtarët kanë shprehur shqetësime jo vetëm për programet e prekura, por edhe për faktin se Kongresi po ia dorëzonte kompetencat e tij për shpenzimet degës ekzekutive, pasi investimet e miratuara në mënyrë dypartiake po anuloheshin më pas me vota të ndara sipas vijës partiake. Ata kanë thënë se përpjekjet e mëparshme për anulim kishin pasur të paktën mbështetje të pjesshme dypartiake dhe e përshkruan paketën republikane si të paprecedentë. Asnjë demokrat nuk e ka mbështetur paketën kur ajo ka kaluar në Senat me 51 vota për dhe 48 kundër. Paketa anulon rreth 1.1 miliardë dollarë për Korporatën për Transmetimin Publik dhe gati 8 miliardë dollarë për një sërë programesh për ndihmat jashtë vendit,

shumë prej të cilave synojnë t'i ndihmojnë vendet që përballen me thatësi, sëmundje dhe paqëndrueshmëri politike. Ndër shkurtime për ndihmat amerikane në botë përfshihen: 800 milionë dollarë për një program që ofron strehim emergjent, ujë dhe ribashkimin e familjeve për refugjatët, 496 milionë dollarë për të siguruar ushqim, ujë dhe kujdes shëndetësor për vendet e goditura nga katastrofat natyrore dhe konfliktet. Gjithashtu, përfshihet një shkurtime prej 4.15 miliardë dollarësh për programet që synojnë forcimin e ekonomive dhe institucioneve demokratike në vendet në zhvillim. Shtëpia e Bardhë ka argumentuar se shumë nga këto shkurtime do të nxisin vendet e tjera të marrin më shumë përgjegjësi në përballjen me krizat humanitare dhe se anulimi i fondeve i shërben më së miri taksapaguesve amerikanë.

Britania ul në 16 vjeç moshën për pjesëmarrje në votime

LONDËR, 18 KORRIK - Qeveria britanike ka njoftuar se do t'i lejojë personat prej 16 vjeç që të votojnë në zgjedhjet e përgjithshme, një ndryshim i rëndësishëm në këtë shtet. Partia Laburiste në pushtet ishte zotuar edhe më herët për ulje të moshës nga 18 në 16 për pjesëmarrje në procese zgjedhore. Kjo duket se është vetëm një prej plot reformave

që do të bëhen. Disa argumentojnë se demokracia e Britanisë është "në krizë", sidomos për shkak të daljes së ulët në zgjedhje. Ndryshimi i moshës së votimit ka qenë i diskutueshëm për kohë të gjatë. Disa kritikë kanë thënë më parë se diçka e tillë është në shërbim të pushtetit, për faktin se adoleshentët që sapo

kishin fituar të drejtën e votës konsideroheshin më të prirë të mbështesnin Partinë Laburiste të qendrës së majtë. "Mendoj se është shumë e rëndësishme që 16 dhe 17-vjeçarët të votojnë, sepse janë mjaftueshëm të rritur për të punuar, për t'i paguar taksat, pra ata kontribuojnë. Nëse kontribuoni duhet ta keni mundësinë të tregoni se si

dëshironi të shpenzohen paratë tuaja, apo për cilën qeveri duhet të shkojnë", ka thënë kryeministri britanik, Keir Starmer. Qeveria do të duhet ta dorëzojë legjislacionin para parlamentit, ku e ka shumicën e mjaftueshme për t'i bërë ndryshimet. Sipas të dhënave online, vetëm një numër i vogël shtetesh i



lejojnë 16-vjeçarët që të votojnë në zgjedhjet e përgjithshme. Aty përfshihen Austria, Argjentina, Brazili, Ekuadori dhe Kuba.

GJYKATA NË HAGË, GJYKATË PARALELE SERBE PËR KOSOVËN



Shkruan: Kudusi LAMA

Po dëgjoj nëpër televizione dhe lexoj nëpër shkrime të thuhet se Gjykata Speciale në Hagë e themeluar nga Kuvendi i Kosovës është gjykatë politike. Më duket se në kushtet ku jeton shoqëria sot dhe ku po kalojnë gjithë popujt, jo vetëm shqiptarët, të gjitha gjykatat janë politike. Gjykata të drejtësisë hyjnore dhe jetësore të së drejtës nuk besoj se ka pasur as nuk besoj se do të ketë edhe disa shekuj. Por në kushtet e kësaj gjykate - Gjykatës Speciale në Hagë të themeluar nga Kuvendi i Kosovës, duket se kemi të bëjmë me një mostër të pashoqe në historinë e kohës tonë, pa pretenduar të them se nuk ka ndodhur kurrë, pasi nuk di a kam njohuri të plota për këtë. Kjo gjykatë është gjykatë paralele serbe për Kosovën. Kjo gjykatë vërtet u themelua nga Kuvendi i Kosovës, por me mashtrimin e Evropës.

Evropa u bë garante e të drejtës në analizën e ecurisë së kësaj gjykate, por që e tradhtoi ose e la në harresë këtë çështje sapo kjo gjykatë u krijua me vullnetin e parlamentit të Kosovës. Shqip kësaj i thonë prerje në besë. Evropa, siç duket, e kishte të qartë që në fillim të këtij akti, se po krijonte një gjykatë paralele serbe për Kosovën, të krijuar nga Kosova, por që do të punonte për interesat e Serbisë. Është për t'u çuditur sa pa dhimbje na kanë mashtruar. Sepse i drejti edhe mashtrohet. Shqiptarët e miratuan atë gjykatë, duke e ditur se nuk i kishin borxh askujt asgjë. Nuk u kishte shkuar mendja luftëtarëve se Evropa po ngrinte një kurth kundër tyre, për t'i vënë në bankën e të akuzuarit, pse kanë luftuar për ta çliruar atdheun e tyre. Tashmë është kuptuar qartë, se kjo Gjykatë Speciale në Hagë e themeluar nga Kuvendi i Kosovës, nuk është gjë tjetër veçse gjykatë serbe për Kosovën. Është i pabesueshëm një akt i tillë në këtë kohë moderne të popujve të qytetëruar. Si ka mundësi të bëhet një pabesi kaq e madhe kundër një populli që ka luftuar 100 vjet për çlirim nga pushtimi, duke e gjykuar për interesat e

pushtuesit, me metodat e pushtuesit, duke marrë peng pikërisht personazhet që i ka dënuar edhe pushtuesi, me dëshmitarët e pushtuesit, me dokumentet e pushtuesit, në marrëdhënie me prokurorët e pushtuesit? Këtë mundi ta bëjë vetëm Evropa "moderne". Kështu që kemi ardhur në atë stad, për të parë qartë, se jemi përballë një gjykate paralele serbe për Kosovën, që nuk jep llogari për asgjë dhe nuk i jep llogari askujt. Kuptohet jep llogari atje ku merr instruksionet dhe dosjet e akuzave - në Beograd. Kjo gjykatë tashmë duket qartë se është mostra e kohës sonë. Evropa bën mirë të distancohet sa më parë prej saj. Të kuptojë se ka gabuar, në qoftë se nuk është bërë me qëllim themelimi i kësaj gjykate prej saj. Për më tej, do të bëj apel e thirrje shtetit të Kosovës, institucioneve shoqërore, kulturore, arsimore dhe ekonomike, si dhe gjithë organizatave e shoqatave të ndryshme në Kosovë, ashtu Organizatës së Veteranëve të UÇK-së dhe shoqatave të dala prej saj, gjithë popullit të Kosovës: Të organizohet një referendum gjithë popullor, për ta quajtur këtë gjykatë jo përfaqësuese e popullit të Kosovës, për ta quajtur këtë

gjykatë me emrin e vërtetë të saj - gjykatë paralele serbe për Kosovën. Dhe nëse pretendohet në Kosovë se janë shkrirë apo duhen shkrirë strukturat paralele serbe, e para që duhet shkrirë si strukturë paralele që po na shkatërrojnë historinë tonë është Gjykata Speciale e ngritur në Hagë. Për këtë do të apeloja gjithë sistemit të drejtësisë në Kosovë, të përcaktojë arsyetimet që të bëjë të qartë për të gjithë ligjërisht se kjo gjykatë është institucion paralel serb në e për Kosovën dhe u shërben vetëm interesave serbe e ndëshkon Kosovën dhe nuk i jep llogari Kosovës. Shqiptarët e të gjitha kategorive duke filluar nga kryetari i shtetit e deri te qytetari i fundit i vendit tonë, duhet të jenë të qartë se Serbia edhe me ligj ka krijuar sistem gjyqësor të veçantë për Kosovën, çka e intensifikon më tej trysninë në drejtim të vënies nën kontroll të jetës ligjore në Kosovë në ditët e sotme, pasi e di se për periudhën e Luftës Çlirimtare të Kosovës e ka plotësisht nën kontroll nëpërmjet Gjykatës Speciale në Hagë. Evropa dhe gjithë opinioni ndërkombëtar duhen vënë përballë unitetit të popullit të

Kosovës dhe institucioneve që ai ka ndërtuar për ta udhëhequr, si dje në luftë. Po e bëmë këtë asnjë institucion serb nuk do të mund më të funksionojë paralel për të na vlerësuar e dënuar jetën dhe historinë tonë. Nëse Evropa ka synime të fshehta e kemi për detyrë ne ta detyrojmë t'i bëjë publike. Por nuk mund të lejohet të tolerohet ilegaliteti serb nën maskën e forcës së Evropës. Çdo gjykatë e Kosovës dhe për Kosovën, i jep llogari Kosovës dhe popullit e institucioneve të Kosovës. Kujt i jep llogari Gjykata Speciale në Hagë e themeluar nga Parlamenti i Kosovës?!!! Ekzistenca e kësaj gjykate paralele serbe për Kosovën është kompromis me sovranitetin e vendit. Dua të besoj se askush në Kosovë nuk e pranon këtë kompromis. Të ja dërgojmë pra Evropës e gjithë opinionit ndërkombëtar 2 milionë e gjysmë kundërshtime të popullit të Kosovës, për veprën mostër të kësaj Gjykate Speciale në Hagë të themeluar nga Parlamenti i Kosovës, por që doli të jetë gjykatë paralele serbe për Kosovën. Jemi të lirë, jemi shtet, jemi NE. Të mos lejojmë askënd të na konsiderojë se nuk jemi të lirë, se nuk jemi shtet.

RRËZIMI I MOCIONIT NDAJ LIDERËVE TË UÇK-së, GUCATI: ATA S'MËRZITEN, JANË TË BINDUR SE DO TË DALIN FITIMTARË

PRISHTINË, 18 KORRIK - Më 16 korrik Gjykata Speciale në Hagë ka refuzuar plotësisht mocionin e mbrojtjes që kërkonte heqjen e disa fakteve materiale nga aktakuzave ndaj liderëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi. Për këtë çështje ka folur të premten kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati, i cili ka përcjell nga afër këtë proces dhe aktualisht gjendet në Hagë. Gucati ka kërkuar që mos t'i besohet Gjykatës Speciale, e cila, sipas tij, është e njëanshme dhe politike. "Ne kemi thënë me kohë se kësaj gjykate nuk duhet t'i besohet. Kjo gjykatë është e njëanshme, është një gjykatë politike dhe na ka befasuar të gjithëve me vendimin brutal e që e mori shumë shpejt, me një pauzë shtatë-tetë minutëshe, ku pastaj hynë në sallë dhe e hodhën poshtë mocionin e mbrojtjes së Thaçit dhe të tjerëve. Ne nuk jemi ndjerë mirë. Po them sinjorisht se ne jemi pa zot shtëpie, jemi si jetim në njëfarë forme sepse

institucionet tona nuk janë duke u interesuar sa duhet për ata shokë që i kemi në burg, për ata bashkëluftëtarë apo qytetarë, apo burra të shtetit", ka thënë Gucati për "Klan Kosovën". Më tutje, Gucati ka shprehur bindjen e tij se të gjithë ata që janë në proces gjyqësor në Hagë do të dalin fitimtarë. Gucati ka theksuar se nuk ka gjasa që bashkëluftëtarët e tij të dënohen për krime lufte. "Ata ndihen shumë mirë. Ata nuk mërzhiten fare. Ata thonë se mund të na dënojnë se e kanë fuqinë. Padrejtësia mundet me ndodh nëse do gjykata mundet me i dënuar politikisht, por për krime lufte asnjëherë. Ata madje shprehen të bindur se do të dalin fitimtarë", ka thënë Gucati. Kujtojmë se në maj të vitit 2022 Hysni Gucati së bashku me zëvendësin e tij në OVLUÇK, Nasim Haradinaj, ishin dënuar me katër vjet e gjysmë burgim për akuzat për pengim të drejtësisë, derisa më 17 tetor 2023, Specialja kishte modifikuar dënimin ndaj Gucatit, duke i mundësuar atij lirin nga burgu, nën disa kushte.





'JORELAVANT', 'MASHTRUESE' - MARRËVESHJA E UASHINGTONIT PËRPLAS OSMANIN DHE HOTIN

Vjosa Osmani dikur thurte lavde për Avdullah Hotin, ndërsa tani është duke e quajtur jorelevant ish-bashkëpartiakun. Jorelevanca e Osmanit për Hotin ka ardhur në shprehje për shkak të marrëveshjes së Uashingtonit të cilën shefja e shtetit dikur e quante kundër rendit kushtetuese, ndërsa gjatë vizitës së fundit në ShBA, por edhe në Prishtinë, ka thënë se kjo marrëveshje është zbatuar nga ana e Kosovës. Ndaj kësaj deklarate ka reaguar Hoti, i cili ka thënë se Osmani për pesë vjet është marrë me demagogji dhe mashtrime. Ai ka vlerësuar se Osmani e ka hallin se do të mbetet në histori si mashtruesja më e madhe e elektoratit djathtist të LDK-së

ka zbatuar Kosova? Njerëzit duhet të kujdesen shumë të mos shndërrohen në altoparantë të Serbisë këtu me akuza të tilla", ka thënë Osmani.

Hoti: Vjosa e ka hallin se do të mbetet në histori si mashtruesja më e madhe e elektoratit djathtist të LDK-së

Pas kësaj deklarate, i menjëhershëm ka qenë reagimi i Avdullah Hotit, i cili ka thënë se Osmani për pesë vjet është marrë me demagogji dhe mashtrime. Hoti ka vlerësuar se Osmani e ka hallin se do të mbetet në histori si mashtruesja më e madhe e elektoratit djathtist të LDK-së. "Po i mbaron mandati 5-vjeçar në krye të shtetit të Kosovës pa asnjë rezultat e pa asnjë kontribut për shtetin e Kosovës. Pesë vite demagogji e mashtrime, të cilat po dalin sheshit. Pesë vite në shërbim të agjendës shtettrënuese të bashkë-mashtruesit. Ky është problemi që ka Vjosa. Kjo e ka hallin se do të mbetet në histori si mashtruesja më e madhe e elektoratit djathtist të LDK-së", ka thënë Hoti, duke shtuar se Osmani do të mbahet përgjegjëse dhe bashkëfajtoare për rrënimin e reputacionit të shtetit të Kosovës. "Kjo e ka hallin se në prill e dorëzon mandatin dhe do të mbahet përgjegjëse dhe bashkëfajtoare për rrënimin e reputacionit të shtetit të Kosovës dhe dëmet që i janë bërë e po i bëhen shtetit të Kosovës. Asnjë fjalë nuk e flet për vendimet e organeve të drejtësisë që konstatojnë uzurpimin e institucioneve nga LV-ja dhe partnerët e saj, përfshirë ish-partinë e saj Guxo", ka thënë Hoti. Hoti nuk është ndalur me kaq. Ai edhe të premten ka adresuar kritikë të ashpra për presidenten

Osmani dhe kryeministrin në detyrë, Albin Kurti. Ai ka thënë se Kurti dhe Osmani tanimë kanë hyrë në historinë politike të Kosovës si mashtrues të elektoratit dhe dëmtues të shtetit të Kosovës. "Dy krerët e shtetit, kryeministri dhe presidentja, tanimë kanë hyrë në historinë politike të Kosovës si mashtrues të elektoratit dhe dëmtues të shtetit të Kosovës. Në përmbyllje të mandatit të tyre pesëvjeçar në krye të shtetit, po bëjnë përpjekjet e fundit dëshpëruese. I pari, duke i mbajtur të bllokuara institucionet e vendit dhe duke mos iu përgjigjur drejtësisë, ndërkohë që korrupsioni ka lulëzuar gjithandej. E dyta, po përpiqet të gjejë viktimën e radhës për ta mashtruar për një mandat tjetër apo për rikthim në garën politike elektorale. Skena politike është pa ide, angazhim dhe guxim për të ofruar zgjidhje", ka deklaruar Hoti.

Marrëveshja e Uashingtonit, Gashi i del në mbrojtje Hotit: Osmani dhe Kurti dikur thoshin 'tradhti kombëtare', sot e quajnë 'arritje historike'

Deputeti i LDK-së, Arben Gashi, i ka dalë në mbrojtje kolegut, Avdullah Hotit, të cilin presidentja Osmani e ka vlerësuar jorelevant për të folur për marrëveshjen e Uashingtonit. Gashi i ka kritikuar presidenten Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti për veprime dhe deklarata kundërkushtetuese. Ai ka vlerësuar se të dy krerët e shtetit i kanë ndryshuar qëndrimet për Marrëveshjen e Uashingtonit, e cila në shtator të vitit 2020 është nënshkruar nga Avdullah Hoti në Shtëpinë e Bardhë. Gashi ka thënë se Osmani dhe Kurti dikur thoshin se kjo marrëveshje

kundërkushtetuese dhe tradhti kombëtare, kurse sot e quajnë "arritje historike". "Pas pesë vitesh në pushtet, presidentja dhe kryeministri vazhdojnë me veprime dhe deklarata kundërkushtetuese. Ata që dikur thoshin se marrëveshja e Uashingtonit ishte kundërkushtetuese dhe tradhti kombëtare, sot e quajnë 'arritje historike' dhe 'sukses për Kosovën'. Le t'ia lëmë historisë gjykimin për të shkuarën", ka deklaruar Gashi, duke shtuar se Kosova meriton lidhshmëri më të mirë. "Por detyra jonë është të flasim për sot. Çfarë po bëjnë ata për: konstituimin e institucioneve? Ruajtjen e aleancave strategjike? Zhvillimin ekonomik të vendit? Sigurinë kombëtare? Sot, në vend të vizionit ka konfuzion. Në vend të besimit ka pasiguri. Në vend të aleancave ka izolim. Në vend të mobilizimit ka apati. Kosova meriton më shumë. Qytetarët meritojnë lidhshmëri të qartë, përgjegjëse dhe të besueshme", ka shkruar Gashi. Edhe nënkryetarja e LDK-së i ka dalë në mbrojtje Avdullah Hotit, duke publikuar edhe një fotografi të tij me presidentin amerikan Donald Trump në Zyrën Ovale, ku ishte nënshkruar marrëveshja e Uashingtonit, pjesë e së cilës ka qenë edhe njohja e Kosovës nga Izraeli. Vjosa Osmani ka qenë pjesë e LDK-së. Ajo në zgjedhjet e vitit 2019 ka qenë kandidatë për kryeministër nga kjo parti dhe më vonë ishte bërë kryetare e Kuvendit si pjesë e partisë që drejtohej nga Isa Mustafa. Në vitin 2021 Osmani kishte ndarë rrugët me LDK-në duke u bërë bashkë me Albin Kurtin dhe më pas ishte bërë presidente. Pa votat e LDK-së, Osmani do ta kishte ta pamundur që të bëhej presidente në vitin 2021.

EPOKA E RE**Lirim GECI**

PRISHTINË, 18 KORRIK - Marrëveshja e Uashingtonit, e cila ishte nënshkruar në vitin 2020, ka përplasur verbalisht presidenten Vjosa Osmani dhe nënshkruesin e kësaj marrëveshje, Avdullah Hoti, i cili në atë kohë ishte kryeministër i Kosovës. Kjo përplasje ka nisur pas një deklarate të Osmanit gjatë vizitës së fundit në ShBA ku e kishte lavdëruar marrëveshjen e nënshkruar nga Hoti dhe presidenti amerikan Donald Trump. Kjo deklarate fillimisht ishte komentuar nga Hoti, duke ia rikujtuar Osmanit se më herët kishte thënë se marrëveshja e Uashingtonit cenon rendin kushtetues të Kosovës. "Asgjë e re nga Osmani, vetëm hipokrizi e radhës! Osmani, që dikur e quante Marrëveshjen e Uashingtonit cenim të rendit kushtetues dhe rrezik për shtetin, sot, pas 5 vitesh e quan 'marrëveshje të mirë' dhe madje pretendon se 'e kemi zbatuar'. Kjo është ajo që ndodh kur fitimi dhe mbajtja e pushtetit bëhet më i rëndësishëm se interesi shtetëror. Marrëveshja që

dikur e luftonte për vota, sot shërben për lavdi të reme. Jo, ti e Kurti nuk e keni zbatuar këtë marrëveshje. E keni luftuar atë. Tani po mundoheni ta përvetësoni kur kanë ndryshuar rrethanat politike në ShBA. Ky është kulmi i mashtrimit politik", kishte shkruar Hoti në "Facebook" më 12 korrik. Për marrëveshjen e Uashingtonit presidentja Osmani është pyetur nga gazetarët të enjten në një konferencë për medie, të cilën shefja e shtetit e ka mbajtur pas kthimit nga vizita në ShBA. Në këtë konferencë Osmani përsëri ka folur për zbatimin e marrëveshjes së Uashingtonit dhe kur është pyetur nga gazetarët për deklaraten e Hotit, ajo ka shpërthyer ndaj ish-bashkëpartiakut për të cilin dikur thurte lavde. Në këtë kontekst, Osmani e ka quajtur jorelevant. "Hoti është njeriu më jorelevant në të cilin nuk dua të humb asnjë sekondë. Nëse doni ta bëni si pyetje tuajën, se a është zbatuar marrëveshja apo jo, vetëm Serbia e akuzon Kosovën për moszbatim të marrëveshjeve. A e keni lexuar marrëveshjen? Cilën pjesë nuk e

NGA FISKALIZIMI TEK URAT: VENDIMET E QEVERISË NË DETYRË VIHEN NË PIKËPYETJE

Qeveria në detyrë e Kosovës ka miratuar rreth 12 vendime pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit. Ministrat në detyrë kanë miratuar edhe udhëzime administrative, në mesin e tyre atë për përdorimin e pajisjeve fiskale elektronike, të cilin Gjykata Supreme e ka shpallur të paligjshëm. Shumica e ministrave në qeverinë në detyrë janë edhe deputetë të Kuvendit, i cili nuk është konstituuar ende për shkak të mosmarrëveshjeve politike midis partive parlamentare. Lidhur me këto vendime, ekspertët e drejtësisë kanë vlerësuar se vendimi i Supremes e ka bërë të qartë se qeveria në detyrë ka shkelur Kushtetutën dhe ligjet, duke i lënë deputetët ta kryejnë edhe funksionin e ministrave

PRISHTINË, 18 KORRIK - Qeveria në detyrë e Kosovës ka miratuar rreth 12 vendime pas datës 27 mars, kur janë shpallur rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve parlamentare. Një nga vendimet e fundit, që është publikuar më 9 korrik në Gazetën Zyrtare të Kosovës, ka të bëjë me ndërtimin e një shkolle të muzikës dhe të një muzeu në Luginën e Preshevës, për çka janë ndarë rreth gjysmë milioni euro. Aty ka edhe vendime për shqyrtimin e shpronësimit të tokës në rajonin e Gjilanit, emërimin e drejtorit të Bordit udhëheqës për ndërmarrje publike, rritjen e përfitimeve për nënat e të tjera.

Ministrat në qeverinë në detyrë kanë miratuar edhe udhëzime administrative - në mesin e tyre ai për përdorimin e pajisjeve fiskale elektronike, të cilin Gjykata Supreme më 15 korrik e ka shpallur të paligjshëm dhe e ka anuluar.

Gjykata ka konstatuar se një qeveri në detyrë mund të kryejë vetëm aktivitetet të domosdoshme dhe ato të planifikuara në planin vjetor të punës së qeverisë, dhe se nuk ka të drejtë të miratojë akte të reja nënligjore. Ky udhëzim ishte botuar në Gazetën Zyrtare më 16 prill dhe ishte lëshuar nga ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, deputet në Kuvendin e Kosovës.

Përndryshe, shumica e ministrave në qeverinë në detyrë të Kosovës janë deputetë në institucionin ligjvënës, i cili nuk është konstituuar ende për shkak të mosmarrëveshjeve politike midis partive parlamentare.

Qeveria në detyrë, e udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti, dhe vetë ministri në detyrë, Murati, e kanë kritikuar vendimin e Gjykatës Supreme, duke e quajtur “arbitrar” dhe të pabazuar në ligj. Ndërsa ambasadori i BE-së në Kosovë, Aivo Orav dhe ambasadori gjerman Jorn Rohde kanë reaguar gjithashtu, duke vlerësuar se ndërhyrja politike në gjyqësor është “e papranueshme”.

Çfarë do të ndodhë me vendimet e marra nga qeveria në detyrë?

Profesori Kadri Kryeziu, ish-nënkryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se qeveria në detyrë, sipas vendimit të Gjykatës Supreme, është e detyruar t’i tërheqë vendimet e marra pas 27 marsit, datë kur janë konfirmuar mandatet e deputetëve në Kuvendin e Kosovës. “Vendimet e Gjykatës Supreme janë finale për aq sa i përket interpretimit të ligjit, përfshirë edhe atë për Qeverinë”, ka thënë ai, duke shtuar se në vendimin e 15 korrikut Gjykata Supreme “ka bërë referenca kushtetuese që lënë hapësirë për përfshirjen e mundshme të Gjykatës Kushtetuese”, nëse palët vendosin të ndjekin një rrugë të tillë.

“Sipas mendimit tim, Ligji për Qeverinë është i hartuar dobët dhe keq, ka shumë dykuptimësi, por edhe kontradikta. Kjo lë hapësirë që çështja të politizohet dhe kjo nuk është gjë e mirë”, ka thënë Kryeziu.

Kurse Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi ka vlerësuar se vendimi i Gjykatës Supreme e ka bërë të qartë se qeveria në detyrë ka shkelur Kushtetutën dhe ligjet, duke i lënë deputetët ta kryejnë funksionin e ministrave. “Prandaj, të tetë ministrat, përfshirë kryeministrin, të cilët mbajnë dy poste, po e shkelin ligjin”, ka thënë Miftaraj për “Radion Evropa e Lirë”. Sipas tij, të gjitha vendimet e marra nga ministrat në qeverinë në detyrë mund të kundërshtohen në gjykatë dhe të përmbysen. “Qeveria është e detyruar ta respektojë dhe ta zbatojë vendimin e Gjykatës Supreme”, ka thënë Miftaraj.

Çfarë vendimesh mori qeveria në detyrë?

Të gjitha vendimet e Qeverisë së Kosovës hyjnë në fuqi kur publikohen në Gazetën Zyrtare të Kosovës, dhe kështu shihet se më 28 mars është publikuar vendimi për shqyrtimin e kërkesave për shpronësime në interesin publik në rajonin e Gjilanit. Pastaj më 14 prill është publikuar vendimi për zgjatjen e mandatit të Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Përdhunuar gjatë Luftës në Kosovë, ndërsa më 16 prill është publikuar vendimi për emërimin e drejtorit të Bordit udhëheqës të ndërmarrjes publike rajonale për furnizim me ujë në rajonin e Prizrenit, me mandat trevjeçar. Vendimi për emërimin e drejtorit ekzekutiv të Agjencisë për Arsim



dhe Trajnim Profesional dhe Arsim për të Rritur për një mandat katërvjeçar është botuar në Gazetën Zyrtare më 29 maj, ndërsa vendimi për rritjen e përfitimeve në para për nënat u botua më 5 qershor.

Ndërsa më 27 qershor hyri në fuqi vendimi i Qeverisë së Kosovës për t’i miratuar ndarjet financiare - në vlerë prej 4 milionë eurosh - për zbatimin e masës “Mbështetje për Diasporën” nga Paketa e Rimëkëmbjes Ekonomike.

Në Gazetën Zyrtare të Kosovës mund të shihet, po ashtu, se ministrat në detyrë kanë nxjerrë edhe rregullore dhe vendime administrative. Për shembull, Udhëzimi Administrativ nr. 01/2025 për shfrytëzimin e pajisjeve elektronike fiskale, sistemeve fiskale dhe softuerëve elektronikë fiskalë, i lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, është botuar në Gazetën Zyrtare më 16 prill.

Udhëzimi Administrativ për ndryshimet dhe plotësimet e Udhëzimit Administrativ për lejet mjedisore, i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura, është publikuar më 28 maj. Udhëzimi Administrativ për ndryshimet në listën e organizmave të dëmshëm për bimët dhe produktet bimore, i lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, është botuar në Gazetën Zyrtare më 20 qershor.

Edhe Prokuroria heton kontratat e qeverisë

Prokuroria Speciale e Kosovës ka njoftuar më 10 korrik se ka nisur hetimet lidhur me ligjshmërinë e kontratës për ndërtimin e dy urave të reja mbi lumin Ibër në Mitrovicë, e cila është lidhur nga Qeveria në detyrë e Kosovës.

Në deklaratë ishte thënë se hetimi i Prokurorisë nuk kundërshton ndërtimin e vetë urave, por fokusohet në “përmbytjen e detyrimeve ligjore” që lidhen me kontratën për ndërtimin e tyre. Këto dy ura parashihet të ndërtohen në kuadër të një projekti të bazuar në një memorandum bashkëpunimi midis Ministrisë së Infrastruktura të Kosovës, përgjegjëse për komunën e Mitrovicës së Veriut dhe të Jugut. Qeveria në detyrë e Kosovës ka ndarë rreth tre milionë euro për ndërtimin e tyre, ndërsa punimet pritet të përfundojnë në vjeshtë. Zyra e Prokurorit ka thënë se nuk është në juridiksionin e saj të vlerësojë ose miratojë projekte infrastrukturore, por se “roli i Zyrës së Prokurorit Special është të veprojë në përputhje me ligjet në fuqi, në rastet kur ka dyshime për keqpërdorim të fondeve publike”. Pesë prokurorë është thënë se janë angazhuar për të shqyrtuar dy mijë kontrata të lidhura nga qeveria.

HASANI: KURTI KA UZURPUAR POSTET NË EKZEKUTIV, PAS VENDIMIT TË SUPREMES MUND TË KETË PASOJA PENALE



PRISHTINË, 18 KORRIK - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti dhe ministrat në detyrë, të cilët janë certifikuar edhe si deputetë, kanë uzurpuar pozitat ekzekutive, kështu ka vlerësuar profesori i së Drejtës Ndërkombëtare, Enver Hasani, i cili në të kaluarën ka qenë kryetar i Gjykatës Kushtetuese. Sipas tij, një gjë e tillë konfirmohet edhe në aktgjykimin e Gjykatës Supreme të cilin e ka vlerësuar profesional dhe detyrimisht të zbatueshëm, pasi i njëjti, sipas tij, nuk mund të ankimohet në Gjykatën Kushtetuese nga ekzekutivi në detyrë.

Gjykata Supreme, më 15 korrik, ka

marrë vendim se nxjerrja e akteve nënligjore nga ministrat që janë njëkohësisht deputetë është e kundërligjshme, pasi shkelën dispozitat kushtetuese.

Hasani ka thënë se çdo mospërfillje e aktgjykimit të Supremes mund të përbëjë shkelje penale për ministrat në detyrë, të cilët janë certifikuar edhe si deputetë pas zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit. “Supremja nuk e ka interpretuar Kushtetutën, por vetëm e ka zbatuar atë, ashtu siç e detyron Kushtetuta”, ka thënë Hasani për “Kosovapress”.

Qeveria në detyrë ka reaguar kundër vendimit të Supremes,

duke e konsideruar atë arbitrar dhe të njëanshëm, madje kanë paralajmëruar edhe dërgimin e vendimit në Gjykatën Kushtetuese. Megjithatë, profesori Hasani ka thënë se qeveria nuk ka të drejtë t’i dërgojë vendimet e Gjykatës Supreme në Kushtetuese. Sipas tij, aktgjykimi i Supremes është detyrimisht i zbatueshëm dhe nuk mund të ankimohet.

Ai ka ngrehur dyshime nëse ministrat në detyrë, të cilët janë certifikuar edhe si deputetë, do ta zbatojnë aktgjykimin e Supremes. Por, sipas tij, moszbatimi i vendimit mund të ketë pasoja penale dhe prokuroria duhet të jetë vigjilente në këtë drejtim.

Me 'Forcën e Re Kombëtare', Ferid Agani rikthehet në skenën politike

PRISHTINË, 18 KORRIK - Kosova është bërë me një parti të re. Bëhet fjalë për nismën politike konservatore "Forca e Re Kombëtare", e iniciuar nga ish-ministri i Shëndetësisë dhe ish-kryetari i Partisë së Drejtësisë, Ferid Agani.

"Më 14 dhe 17 korrik u mbajt mbledhja konstitutive e Këshillit Organizativ të nismës politike konservatore 'Forca e Re Kombëtare', si hap i rëndësishëm

drejt themelimit të subjektit të ri politik që synon të sjellë frymë të re të përfaqësimit qytetar, identitar, moral dhe kombëtar në skenën politike të Kosovës", ka njoftuar "Forca e Re Kombëtare".

Këshilli Organizativ i këtij subjekti ka theksuar se është pajtuar që procesi i themelimit të subjektit të ri politik të mbështetet në parimin e bashkimit të Partisë së Drejtësisë me Grupin Politik të

Intelektualeve "Integriteti", duke e shkrirë trashëgiminë 25-vjeçare me vizionin e ri, në frymën e parimit të barazisë së plotë ndërmjet dy partnerëve politikë. Me këtë akt themelues, "Forca e Re Kombëtare" hyn në një fazë të re të organizimit të saj, me synimin për të ndërtuar një subjekt të përgjegjshëm, të hapur dhe të angazhuar për të mirën e përbashkët të qytetarëve të Kosovës.



OVLUÇK-ja PARALAJMËRON VEPRIME: NËSE DERI MË 26 KORRIK NUK KA KONSTITUIM TË KUVENDIT NUK DO TË RRIMË DUARKRYQ



PRISHTINË, 18 KORRIK - Organizatat e dala nga lufta e UÇK-së u kanë bërë thirrje partive parlamentare, sidomos Lëvizjes Vetëvendosje si parti e parë, që të gjejnë zgjidhje për situatën politike.

Gazmend Sylja nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, në konferencë për medie, ka thënë se 48 tentimet e dështuara për konstituim të Kuvendit tregojnë mungesë të vullnetit politik për zgjidhje. Ai ka rikujtuar se Gjykata Kushtetuese ka caktuar afatin përfundimtar për konstituim më 26 korrik 2025 dhe ka

paralajmëruar se mosrespektimi i këtij vendimi përbën shkelje të Kushtetutës. "Ne si kategori të dala nga lufta e UÇK-së u bëjmë thirrje të gjitha partive politike, me theks të veçantë partisë së parë që ka dalë fituese në zgjedhjet e fundit parlamentare, që urgjentisht të gjejnë zgjidhje për konstituimin e institucioneve, sepse kjo situatë është e papranueshme për ne si kategori të dala nga lufta. Gjykata Kushtetuese, si organi më i lartë juridik në vend, ka dhënë një vendim të qartë: Kuvendi i Kosovës duhet të konstituohet deri më 26

korrik 2025. Moszbatimi i këtij vendimi përbën shkelje të drejtpërdrejtë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ne nuk po kërkojmë privilegje. Ne nuk po kërkojmë favore politike. Ne po kërkojmë vetëm një gjë: zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës", ka thënë Sylja, duke shtuar se nuk do të qëndrojnë duarkryq. "Ne nuk do të qëndrojmë duarkryq nëse nuk ka reflektim", ka thënë Sylja.

Ai ka thënë se Kosova është ndërtuar me gjak dhe nuk do të lejohet që kjo sakrificë të nëpërkëmbet.

NJË MUAJ PARABURGIM PËR POLICIN E DYSHUAR PËR SPIUNAZH

PRISHTINË, 18 KORRIK - Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar masë paraburgimi prej një muaji për policin e ndaluar një ditë më parë, Bojan Jevtiq, nën dyshimet për kryerje të veprave penale spiunazh dhe armëmbajtje pa leje. "Gjykata vlerësoi se nëse i pandehuri lihet në liri, i njëjti mund të ndikojë në prova dhe në dëshmitarë si dhe mund të përsërisë veprën e njëjtë penale, ose mund të kryejë sërish vepra tjera penale në rrethana të njëjta ose më të rënda" është thënë në njoftimin e gjykatës. Prokuroria ka thënë se Jevtiq ka qenë i angazhuar në pozitën e shefit të operativës në policinë kufitare në pikëkalimin kufitar "Dheu i



Bardhë".

Prokurori i rastit, Bekim Kodraliu, ka thënë para medieve se, pas aksionit të kryer një ditë më parë në komunën e Kamenicës, në shtëpinë e Jevtiqit dhe objekte të tjera, janë gjetur prova materiale dhe personale, që vërtetojnë se i dyshuari është duke u marrë me aktivitet të kundërligjshëm.

INAUGUROHET LABORATORI I RI PEDIATRIK NË QKUK

Prishtinë, 18 korrik - Në Spitalin Pediatrik "Sheika Fatima" në Prishtinë është inauguruar një laborator i ri modern si rezultat i bashkëpunimit në mes të Presidencës së Kosovës dhe Fondacionit nga Emiratet e Bashkuara Arabe, "Khalifa Foundation".

Sipas një postimi në rrjetin social në "Facebook" të presidencës, është bërë me dije se ky laborator do t'i mundësojë këtij institucioni publik shëndetësor ta realizojë shumicën e analizave brenda spitalit pediatrik. "Falë angazhimit të presidentes së Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, dhe përkrahjes së vazhdueshme të donatorit tonë të rregullt, 'Khalifa Foundation', dje në Spitalin 'Sheika Fatima', është inauguruar laboratori i ri. I pajisur



me teknologji bashkëkohore, ky laborator do t'i mundësojë këtij institucioni publik shëndetësor të realizojë shumicën e analizave, brenda vetë spitalit pediatrik. Kjo do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e efikasitetit, cilësisë dhe qasjes së qytetarëve në shërbime më të avancuara laboratorike, me theks të veçantë tek fëmijët, të cilët janë përfituesit

më të ndjeshëm dhe më të rëndësishëm të këtyre investimeve", është thënë në njoftim.

Po ashtu, në njoftim është bërë me dije se një pjesë e konsiderueshme e pajisjeve të reja do të përdoret në Repartin e Neonatologjisë, aty ku kujdesi mjekësor është vendimtar për jetën e foshnjave dhe nënave. "Presidentja Osmani ka shprehur mirënjohje të thellë për popullin e Emirateve të Bashkuara Arabe dhe, në veçanti, për Lartmadhërinë e saj, Sheika Fatima bint Mubarak Al Ketbi, për kontributin e çmuar dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm në përmirësimin e sistemit shëndetësor në Kosovë", është thënë në njoftimin e Presidencës së Kosovës.

Kapiteni i FSK-së, Shkëlqim Raci, nderohet me çmim ndërkombëtar në ShBA

VIRXHINIA, 18 KORRIK - Kapiten Shkëlqim Raci, pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), ka shkëlqyer në arenën ndërkombëtare. Ai ka përfunduar me sukses kursin e karrierës për kapiten në fushën e logjistikës në njërin prej institucioneve më prestigjioze ushtarake në

ShBA - "Army Sustainment University", Fort Lee në Virxhinia. Racit nuk i ka mjaftuar vetëm përfundimi i trajnimit, pasi ai ka dalë në pah mes shumë të tjerëve, duke u nderuar me çmimin e veçantë "Distinguished International Honor Graduate", një vlerësim që u

jepet vetëm studentëve ndërkombëtarë me rezultate të jashtëzakonshme akademike dhe profesionale. "Ky sukses i kapiten Racit përbën dëshmi të përkushtimit, profesionalizmit dhe standardeve të larta që përfaqësojnë pjesëtarët e FSK-së në arenën ndërkombëtare", ka njoftuar FSK-ja.



Reagim i KMDLNj-së

DREJTËSI E MUNGUAR PËR RASTIN E DR. HAFIR SHALËS

Më datë 17 korrik 2025 Gjykata Themelore në Prishtinë e dënoi me 15 vjet burgim Sllavisha Filiqin, pjesëtar i Sigurimit Shtetëror të Serbisë. Sllavisha Filiq u dënua shkaku se më 10 prill 1998, bashkë me dy pjesëtarë të Sigurimit Shtetëror serb e ka kidnapuar Dr. Hafir Shalën, duke e futur në një veturë “Opel Frontiera” për ta dërguar në një vend të panjohur dhe prej atij çasti nuk ka më asnjë informatë për Dr. Hafir Shalën. Paraprakisht, në udhëkryqin e Sllatinës nga tre policë ishte ndalë vetura me të cilën udhëtonte Dr. Hafir Shala nga Drenasi për në Prishtinë. Në veturë ishin edhe Hetem Sinani dhe Shaban Neziri të cilët u liruan të njëjtën ditë. Përmes një qytetari nga Lipjani të cilit i ishte dhënë një copë e vogël letre, KMDLNj ishte informuar për arrestimin e Dr. Hafir Shalës dhe shoqëruesve të tij. Pas lirimit, Shaban Neziri dhe Hetem Sinani kishin dhënë deklaratë në zyrën e KMDLNj-së në Prishtinë ku thuhej se dëgjoheshin britmat e Dr. Shalës që ishte nënshtruar një



torture brenda objektit të Sigurimit Shtetëror serb në Prishtinë. Dr. Hafir Shala, Shaban Neziri dhe Hetem Sinani ishin veprimtarë të KMDLNj-së dhe nga terreni sillnin dokumente, deklarata, foto dhe dëshmi për shkelje të drejtave të njeriut në komunën e Drenasit. Dr. Hafir Shala kishte përfunduar Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb, ishte ish-i burgosur politik dhe

bashkëveprimtar i Bacë Adem Demaçit, veprimtar i ShBH “Nëna Terezë”, i KMDLNj-së, mjek dhe themelues i spitalit fushor të UÇK-së, ushtar i UÇK-së dhe aktivist sindikalist. Dy-tri ditë para arrestimit ishte në Zyrën e KNDLNj-së në Prishtinë ku i kishin sugjeruar të mos vijë më në Prishtinë pasi ishte nën përcjellje. Slllobodan Filiq ishte një pjesëtar i Sigurimit Shtetëror të Serbisë

në Prishtinë dhe bashkëpunonte ngushtë me shqipfolësit që ishin pjesë e Sigurimit Shtetëror serb, kryesisht nga Medvegja, të njohur për tortura çnjerëzore ndaj të burgosurve politikë shqiptarë. Slllobodan Filiq ishte gjithashtu nga Medvegja. Pas luftës, sipas informatave të KMDLNj-së, një kohë kishte jetuar në Budva të Malit të Zi, ndërsa tani nuk dihet ku jeton. Ka dyshime se Slllobodan Filiq ka rol të madh edhe në kidnapimin e Xhavit Hazirit për të cilin nuk ka asnjë informatë deri më sot. Burime serbe pas përfundimit të luftës i kanë thënë KMDLNj-së se Dr. Hafir Shalën dhe Xhavit Hazirin i kanë rrëmbyer njësitë e veçanta të Sigurimit Shtetëror të ardhura enkas nga Beogradi. Gjykimi në mungesë me 15 vjet burgim i Slllobodan Filiqit është vetëm përmbyllje e pjesshme e drejtësisë për rastin Dr. Hafir Shala dhe se Filiqi është vetëm një hallkë e zinxhirit të dhunës të Sigurimit Shtetëror të Serbisë. KMDLNj-ja ka kontribuar për ndriçimin e rastit duke bashkëpunuar me institucionet përkatëse dhe përgjegjëse për

rastin. Hetimet, aktakuza dhe gjykimi është dashur të përfshijë të gjithë ata që kanë pasur përgjegjësi politike dhe policore për rastin e jo të përfundojë vetëm me rastin e Slllobodan Filiqit. Ish-pjesëtarët e Sigurimit Shtetëror të Serbisë, të deklaruar si shqiptarë mund dhe duhet të kontribuojnë për zbardhjen e rasteve të Dr. Hafir Shalës dhe Xhavit Hazirit, qoftë duke dhënë informata anonime, qoftë duke bashkëpunuar me institucionet përkatëse të Kosovës. Gjithashtu duhet kërkuar informata nga misionet ndërkombëtare diplomatike dhe jodiplomatike që vepronin në atë kohë në Kosovë. Nuk ka përmbyllje të drejtësisë për rastin e Dr. Hafir Shalës derisa nuk sigurohen informata për fatin e tij dhe derisa nuk nxjerrën para gjykatës urdhërdhënësit e këtij rrëmbimi. Të gjitha konventat që janë të zbatueshme dhe detyruese edhe në kohë lufte sigurojnë mbrojtje për aktivistët humanitarë në ndërkohë që në Kosovë janë shkelur brutalisht nga Serbia.

NJË TJETËR VENDIM PËR RASTIN ‘VETERANËT’, ÇFARË NDODH TASH?

Prishtinë, 18 korrik - Rreth 90 milionë euro është dëmi që besohet se i është shkaktuar buxhetit të Kosovës nga përfituesit e jashtëligjshëm të pensionit për veteranë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Prokuroria pretendon se bëhet fjalë për rreth 19 500 veteranë të rrejshëm. Më 14 korrik, Gjykata Themelore e Prishtinës i ka shpallur fajtorë dhe i ka dënuar me nga një vit burgim ish-kryeministrin e Kosovës, Agim Çeku, dhe 9 të akuzuar të tjerë në rigjykimin e rastit “Veteranët”. Ata besohet se, në cilësinë e anëtarit të Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit dhe të Internuarit të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë keqpërdorur detyrën dhe autoritetin zyrtar, me qëllim që persona të tjerë të përfitonin në mënyrë të kundërligjshme dhe në dëm të buxhetit të shtetit.

Kujt i takon pensioni i veteranit?

Veteranët e luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë, të cilët janë të papunësuar, marrin pension mujor që nga viti 2015. Sipas të dhënave shtetërore, nga rreth 46

mijë veteranë të regjistruar, rreth 37 mijë përfitojnë një pension prej 204 eurosh. Sipas Ligjit për Veteranët e Luftës së UÇK-së, ekzistojnë gjashtë kategori veteranësh: invalidi i luftës, veterani luftëtar, i internuari, pjesëtar, pjesëmarrësi i luftës dhe ushtari i zhdukur i UÇK-së. Po sipas të njëjtit ligj, vetëm ata që e kanë statusin e veteranit luftëtar të UÇK-së kanë të drejtë në pension dhe përfitime shtesë, ndërsa kategoritë e tjera vetëm në përfitime të parapara me ligj. “Pikërisht këtu është problemi. Dhe, ndoshta kjo është çështja që e ka pretenduar edhe Prokuroria, sepse në rast se një pjesëtar ka qenë në kategorinë e logjistikës, por nuk ka qenë luftëtar, këtu ka ndodhur gabimi dhe ai është barazuar me kategorinë e luftëtarit. Këtu ka qenë tejkalimi i autorizimeve, mospërmbyllja e detyrës zyrtare”, ka argumentuar Flamur Kabashi, hulumtues ligjor në Institutin e Kosovës për Drejtësi, në disa përgjigje për “Radion Evropa e Lirë”. Sipas ish-prokurorit special që e ka përgatitur lëndën në këtë rast, Elez Blakaj, në debate publike përmendet qëllimshëm vetëm shprehja veteranë, për të krijuar “mjegull dhe shfajësim”. Ai beson se rasti do të çohet



prapë në Gjykatën e Apelit dhe se kjo gjykatë, më pas, do ta kthejë edhe një herë atë në pikën zero.

Hapat e radhës

Për shkak të kompleksitetit të rastit, Gjykata Themelore pritet që brenda 60 ditësh ta përpilojë vendimin në formë të shkruar, duke i sqaruar rrethanat kryesore se si ka ardhur deri tek ai. Palët - prokuroria apo mbrojtja, kanë afat deri në 30 ditë për ankesë. Në rast se deri atëherë nuk ankohet asnjëra palë dhe vendimi bëhet i formës së prerë, personave të dënuar iu lëshohet

urdhëresa për vuajtje të dënimit me burgim. Megjithatë, disa veçse kanë paralajmëruar ankesë.

Në një situatë të atillë, pra nëse rasti shkon në instanca të tjera, zbatimi i vendimit mbetet pezull - rrjedhimisht nuk do të ketë urdhra për dënime me burgim dhe pensionin do të vazhdojnë ta marrin edhe ata që dyshohet se nuk duhet të jenë pjesë e listës. Përmes vendimit, Gjykata e ka obliguar qeverinë në detyrë të Kosovës që, pasi ai ta marrë formën e prerë, të formojë një komision, i cili do t'i shqyrtonte sërish rreth 19 500 aplikacionet e dyshimta, dhe do t'i largonte nga

lista emrat që nuk i kanë plotësuar kriteret. Kabashi e sheh këtë vendim si zgjidhje alternative, për faktin se për verifikimin e aplikacioneve do të duhej të angazhohej një aparat i tërë për ta analizuar secilin prej tyre. Për disa njohës tërë të të çështjeve të drejtësisë, ky rast duket se është i destinuar që të dështojë. Ata argumentojnë se ka kundërtënie në vendimin e gjykatës, për faktin se është thënë të jetë bërë dëm dhe se janë shqiptuar dënime me burgim, mirëpo gjykata nuk ka arritur t'i verifikojë vetë listat dhe topin ia ka hedhur qeverisë.

Sa veteranë i ka Kosova njëmend?

Ndonëse epilog të rastit nuk ka, për numrin e saktë të veteranëve ka pasur gjithmonë dyshime. Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, pati thënë më 2018 që në luftë nuk ka pasur më shumë se 12-15 mijë luftëtarë me uniformë të UÇK-së, dhe se të gjitha shifrat e tjera janë “mashtime”. Më 2023, kryeministri Albin Kurti pati deklaruar se beson që ka një lloj trefishimi të numrit të veteranëve që, sipas komandantëve të UÇK-së, janë rreth 20 mijë, ndërsa bashkë me pjesëmarrës numri shkon në mbi 60 mijë.

Ismaili dhe Balzi diskutojnë për bashkëpunimin në mes të BQK-së dhe Bundesbankës

PRISHTINË, 18 KORRIK - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, së bashku me zëvendësguvernatorët, ka mirëpritur në takim Burkhard Balz, anëtar i bordit ekzekutiv të Bundesbankës gjermane, së bashku me delegacionin e tij, me rastin e vizitës së parë të nivelit të lartë të Bundesbankës në BQK. Guvernatori Ismaili dhe Balz kanë diskutuar mbi

bashkëpunimin e fortë dhe afatgjatë ndërmjet dy institucioneve, veçanërisht në fushën e menaxhimit të rezervave, operacioneve dhe ngritjes së kapaciteteve. Gjatë takimit guvernatori Ismaili e ka informuar Balzin edhe për zhvillimet e fundit në sektorin financiar të Kosovës dhe për reformat e gjera strukturore të ndërmarra për forcimin e stabilitetit financiar,

modernizimin e infrastrukturës së pagesave dhe përafrimin e kuadrit rregullator me standardet e Bashkimit Evropian. Kjo vizitë pason takimin e fundit të guvernatorit Ismaili me presidentin e Bundes-bankës, Joachim Nagel, në selinë e Bundesbankës në Frankfurt, dhe reflekton thellimin e lidhjeve institu-cionale dhe bashkëpunimit strategjik.



ASK: MË PAK SIPËRFAQE E SHFRYTËZUAR E TOKËS BUJQËSORE MË 2024 SESA MË 2023

PRISHTINË, 18 KORRIK - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e Anketës së Ekonomive Bujqësore (AEB) për vitin 2024. Gjatë vitit 2024 rezultatet e kësaj ankete tregojnë se sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte 420 228.67 hektarë (përfshirë tokën e përbashkët) që, krahasuar me vitin paraprak 2023 (që ishte 420 688.21 hektarë), ka një rënie të sipërfaqes së tokës në shfrytëzim prej 456.3 hektarësh.

Rënie vërehet te toka e përbashkët

Nga gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore në vitin 2024, pjesa më e madhe u përket livadheve dhe kullosave (përfshirë tokën e përbashkët) që ishte 216 534.33 hektarë (51.53 për qind), krahasuar me vitin paraprak 2023 (që ishte 216 979.55 hektarë) ose 51.58 për qind. Rënia e sipërfaqes së shfrytëzuar te toka e përbashkët ishte si rezultat i rënies së numrit të blegtorisë.

Rritje e lehtë vërehet të drithërat dhe kulturat industriale

Toka e punueshme, arat marrin pjesë me 44.93 për qind dhe kopshtet me 0.22 për qind në gjithsej sipërfaqen e



shfrytëzuar të tokës bujqësore. Gjatë vitit 2024, gjithsej toka e punueshme, arat ishin 188 795.00 hektarë. Pjesa më e madhe ishte me drithëra (125 274.35 hektarë ose 66.4 për qind); bimë foragjere (37 117.13 hektarë ose 19.7 për qind); perime në fushë të

hapur, në serra dhe në kopshte (9 827.39 hektarë), prej të cilave perime në fushë të hapur dhe serra ishin 8 914.65 hektarë ose 4.7 për qind; patate (3 806.07 hektarë ose 2.0 për qind); bishtajore (2 929.40 hektarë ose 1.6 për qind); bimë industriale (1 689.82 hektarë

ose 0.9 për qind); kultura të tjera (2 633.81 hektarë ose 1.4 për qind) dhe tokë djerrinë ishte 6 429.78 hektarë ose 3.4 për qind. Sipërfaqe e ujitur, të paktën një herë gjatë periudhës referuese të anketës në vitin 2024, ishte 34 070.28 hektarë, kurse

gjithsej sipërfaqja e trajtuar me pesticide në vitin 2024 ishte 122 570.50 hektarë.

Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore 2023-2024 (hektarë), rënie e lehtë e fondit blegtoral

Rezultatet e kësaj ankete tregojnë se blegtoria në Kosovë, gjatë vitit 2024 sa i përket numrit të gjedheve ishte 240 848, ku krahasuar me vitin paraprak 2023 (që ishte 247 493) ka një rënie të lehtë.

Rritje e lehtë vërehet te numri i deleve

Sa iu përket deleve, gjatë vitit 2024 numri i tyre ishte 211 220 që, krahasuar me vitin paraprak 2023 (që ishte 207 123 dele), ka një rritje të lehtë. Ky publikim ofron të dhëna në formë përmbledhëse për kulturat bujqësore bimore (shfrytëzimin e tokës bujqësore, prodhimtarinë bimore, inputet bujqësore (plehtrat minerale, organike, pesticidet)); blegtorinë (therjet, shitjet, produktet blegtorale) dhe shpenzimet në ekonominë bujqësore. Metodologjia dhe standardet e aplikuar në AEB 2024 (përkufizimet - definicionet, pyetësi, dhe udhëzuesi) janë të harmonizuara me rekomandimet e Eurostatit.

Shqipëria përmirëson deficitin tregtar

TIJANË, 18 KORRIK - Gjysma e parë e vitit 2025 i ka gjetur eksportet shqiptare drejt një qëndrueshmërie përballë sfidave që kanë hasur. Rënia e euros dhe monedha të tjera si dhe faktorët gjeopolitikë prej vitesh i dëmtuan eksportet shqiptare duke humbur terren në arenën ndërkombëtare, por një përmirësim është vërejtur. Tridhjetë e pesë miliardë lekë produkte “Made in Albania” janë regjistruar në qershor, një rritje një pikë

nëntë për qind krahasuar me një vit më parë, raporton “TCh”. Janë grupet e “mineraleve, lëndëve djegëse, energjisë elektrike” me plus nëntë pikë shtatë pikë për qindje, “ushqime, pije, duhan” me plus tre pikë një pikë për qindje që ndikuan më së shumti në këtë qëndrueshmëri të eksporteve. Më shumë këto mallra Shqipëria i ka eksportuar drejt Kosovës, Gjermanisë, Greqisë. Nga ana tjetër ndikuar edhe nga produktet e sezonit dhe

daljes së prodhimit vendas në treg, varësia nga importet është zvogëluar duke rënë me zero pikë dy për qind, në shtatëdhjeteshtatë miliardë lekë. “Materialet e ndërtimit dhe metalet” kanë ndikuar në rënie me një pikë nëntë pikë për qindje dhe “minerale, lëndët djegëse, energjia elektrike” me zero pikë gjashtë pikë për qindje, etj. Kjo ulje e importeve është vërejtur më shumë me Italinë, Turqinë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Një situatë e tillë me një



rritje të eksporteve dhe rënie të importeve ka sjellë dhe një përmirësim të deficit

tregtar me dy për qind duke arritur në dyzet e një miliard lekë.

FRANCA, VERA E ANKTHIT TË MADH

Ky 14 korrik ishte më i hidhur se kurrë për Francën. Festa kombëtare, në vend që të festohej në klimën e zakonshme të krenarisë në mos të madhësisë, kaloi pa u vënë re, ndërsa vendi është i përçarë nga një përplasje e brendshme dhe i kapluar nga një zbrazëti e paprecedentë, në verën e një ankthi të madh shoqëror.

Një vit më parë, Emmanuel Macron dukej se e kishte shpëtuar situatën. Në raundin e dytë të zgjedhjeve legislative ishte krijuar de facto një aleancë qendër-e-majtë që kishte bllokuar rrugën për Rassemblement National të Marine Le Pen dhe Jordan Bardella.

Një lajm i shkëlqyer për Europën: fitorja e lepenistëve, në fakt, do të shënonte fundin e Bashkimit Evropian, në të cilin Franca është e vetmja fuqi bërthamore dhe e vetmja që ka një vend të përhershëm në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Duke kryesuar në sondazhe, blloku i Le Pen doli i treti, pas së majtës dhe të djathtës që janë më pak ose më shumë besnike ndaj Macronit. Presidenti nuk arriti të formojë një qeveri që të pasqyrojë shumicën që doli nga zgjedhjet. Dhe siç shpërbëhen shpejt të gjitha blloqet e tjera, edhe partia e Marine nuk ka shumicën në Asamblenë Kombëtare. Nuk mund të formojë një qeveri, por mund të rrëzojë çdo qeveri. E ka bërë këtë me një kryeministër me përvojë të madhe si Michel Barnier. Ka njoftuar se do ta bëjë edhe në vjeshtë, duke fundosur kryeministrin e ri François Bayrou, nëse nuk do të ndryshojë planin e shkurtimeve të shpenzimeve publike, prej 48 miliardë eurosh.

Shkurtimet, sigurisht, janë të nevojshme. Në një klimë të paqëndrueshmërisë së përgjithshme, Franca është sot i sëmuri i Europës. Më keq se Spanja, ku qeveria mbahet në këmbë me një shumicë të brishtë, më keq se Gjermania që ka krijuar një koalicion për të frenuar rritjen e ekstremist të djathtë, më keq se Mbretëria e Bashkuar, ku Nigel Farage është sot partia e parë. Borxhi publik francez në vlerë absolute e ka kaluar atë italian. Ai është më shumë se dyfishi i kufirit maksimal prej 3% të përcaktuar në Maastricht. Franca ka ngecur në atë grackë që e njohim mirë: borxhi rritet, zhvillimi ndalet, rriten interesat për titujt e borxhit, dhe si rrjedhojë financimi i borxhit bëhet gjithnjë e më i kushtueshëm. Shkurtimet përqendrohen pashmangshmërisht në sektorin publik. Dhe bie një tabu: shërbimi civil i nëpunësve, dikur i konsideruar si kosto e nevojshme për shkak të



përsosmërisë së tij. Macron ishte presidenti i vetëm i zgjedhur në emër të një ndryshimi që francezët nuk ishin gati ta pranonin. Koha kur figura e kreut të Shtetit kishte një aureolë madhështie dhe paprekshmërie ka ikur. Charles De Gaulle kishte ndërtuar rreth vetes një mit të paprekshmërisë, që e stabilizonte si figurën e vetme të shtetit mbi popullin, në zemër të kombit. Kurrë më pas nuk ka ndodhur diçka e ngjashme. Të fundit që i janë afruar asaj presidence absolute, ata e quanin “Dieu”, Zot. Presidenti i fundit me prestigj ka qenë Jacques Chirac, i cili pas një rinie si komunist, ishte ministër i De Gaulle në vitin fatal 1968, dhe dinte të mbante të bashkuar komponentët e shoqërisë, industrialistët dhe sindikalistët, provincën e thellë dhe kryeqytetin, ku kishte qenë kryetar bashkie për tetëmbëdhjetë vjet.

Pas tij, erdhi “përmbytja”. Nicolas Sarkozy u zgjodh me premtimin e një “rupture” (shkëputjeje), por në realitet askush nuk ishte gati. Të shkurtonte shpenzimet për mirëqenien dhe taksat, tolerancë zero ndaj delinkuentëve dhe emigrantëve të paligjshëm, liberalizim të ekonomisë, në mënyrë që, «ai që

punon më shumë të fitojë më shumë». E djathta italiane u dashurua me të me një lehtësi të habitshme, për t’u zhgënjyer më pas, kur ai bashkë me Merkelin vunë në lojë Berlusconi.

Në realitet, ai nuk ishte në lartësinë e ideve të veta, as nuk kishte staturën politike e morale për t’i realizuar ato. Kriza e importuar nga Amerika bëri pjesën tjetër. Por as sot Sarkozy nuk po përmirësohet: në balotazh mori 48,4%, gati 7 milionë vota më pak. Pasardhësi i tij, François Hollande, pesë vjet më vonë nuk u përpoq as të rikandidonte: nuk do të kishte kaluar as raundin e parë.

Macron sapo hyri për herë të parë në Elize, hoqi taksën mbi pasurinë (por jo taksën e trashëgimisë, e cila mund të arrijë deri në 45%). Pas fitores së dytë realizoi reformën shumë të kontestuar të pensioneve. Nga e majta konsiderohet si një president i djathtë, dhe nga e djathta si një president i majtë, ose në çdo rast, një globalist. Tani po përpiqet që në politikën e jashtme të gjejë një “ubi consistam” (një pikë qëndrueshmërie), ose të paktën një formë mbijetese.

Deri në zgjedhjet e ardhshme presidenciale kanë mbetur pak më pak se dy vjet. Disa thonë se do të ishte më mirë të qeverisnin lepenistët, për të imunizuar

kombin, me të njëjtën logjikë me të cilën Mitterrand emëroi si kryeministër rivalin e tij të brendshëm politik, Michel Rocard: «francezët e duan, dhe do ta kenë. Kështu do të kuptojnë kush është vërtet». Qeveria Rocard zgjati dy vjet, pastaj ai u tërhoq nga skena. Në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, në vitin 2027 (nëse Macron nuk jep dorëheqjen më herët, gjë që deri më tani e ka përjashtuar) me siguri do të ketë një kandidat nga Rassemblement National. Për momentin, Marine Le Pen nuk është kandidate, për shkak të një vendimi të gjykatës. Në vend të saj mund të jetë Jordan Bardella, gjashtëmbëdhjetë vite më i ri, realisht ende i papërgatitur. Por nëse do të përballej në balotazh me Jean-Luc Mélenchon, do të fitonte. Mbetet për t’u parë nëse ndërkohë do të shfaqet një reformist, si Gabriel Attal, një i moderuar, si Édouard Philippe, apo ndonjë tjetër që të jetë më pak i njohur, por edhe më pak me peshë.

Por nuk është nga politika që do të vijë ndryshimi. Shoqëria franceze shfaqet e shpërbërë si kurrë më parë. Një shenjë spikat mbi të gjitha: Franca nuk është më përjashtimi evropian: edhe atje ka rënë kurba demografike; edhe francezët, si evropianët e

tjerë, bëjnë gjithnjë e më pak fëmijë, kanë gjithnjë e më pak besim në të ardhmen, më pak entuziazëm për jetën. Edhe rastet e gëzimit, si fitorja e parë e Paris Saint-Germain në Ligën e Kampionëve, shndërrohen në momente dhune. Suksesi i Lojërave Olimpikë të një viti më parë duket shumë larg.

Në ato ditë, parisienët ikën në fshat, dhe Franca provinciale mori kontrollin e kryeqytetit, duke ndezur një zjarr nacionalist më të dukshëm, më të pastër. Por as ky nuk është realiteti. Dhe statistikat flasin për më shumë se dhjetë milionë francezë nën pragun e varfërisë. Në fshatin me kambanore dhe me një shesh qendror, mbyllet një bistrot dhe hapet një dyqan “blej flori”. Pasuria më shumë nxirret, se sa krijohet. Teksa grupet e luksit bëjnë pazar në marka të lavdishme, kryesisht italiane, të rinjtë më të mirë të Francës largohen nga vendi dhe shkojnë atje ku pagat janë më të larta dhe taksat më të ulëta. Një vend i mrekullueshëm, me një pasuri të pallogaritshme historike dhe kulturore, rrezikon që jo vetëm të mos gjejë në udhëheqës që ta mishërojë, por edhe të mos njohë veten. Të mos dijë më se kush është.

Aldo CAZZULLO
(Corriere della Sera – Bota.al)



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Spektakël i 3x3 në kryeqytet

PRISHTINË, 18 KORRIK - Për dy ditë me radhë Sheshi "Ibrahim Rugova" do të jetë arena e basketbollit 3x3. Në kryeqytetin e Kosovës do të organizohet FIBA 3x3 Prishtina Challenger. Kjo garë shumë e rëndësishme ndërkombëtare organizohet nga Prishtina 3x3 në mbështetje

të Federatës së Basketbollit të Kosovës. Në këtë event, që tashmë po organizohet çdo vit, do të marrin pjesë 16 skuadra nga mbarë bota. Nga Prizreni Lite Quest Edition është kualifikuar Valencia. Garat do të jenë nga dita e shtunë nga ora 14:00 deri

në orën 23:00, derisa ndeshjet çerekfinale, gjysmëfinale dhe finalja zhvillohen të dielën nga ora 18:00, kurse ceremonia finale do të jetë nga ora 22:25. Tri skuadrat e para do të kualifikohen në WT Lausanne më 15-16 gusht si pjesë FIBA 3x3 World Tour 2025. Fituesi do

të shpërblehet me 20 mijë euro, vendi i dytë me 15 mijë, i treti me 11 mijë, i katërti me 8 mijë dhe i pesti me 6 mijë. Më 19 dhe 20 korrik do të ketë spektakël të basketbollit 3x3, muzikë, ngulitje atraktive, lojëra shpërblyese dhe shumë befasi për të pranishmit.



LLAPI PARAQET FUTBOLLISTIN NGA BOSNJË-HERCEGOVINA, ENEDIN MULALIQ

"Epoka e re"

PODUJEVË, 18 KORRIK - KF Llapi ka zyrtarizuar një tjetër përforcim për edicionin e ri futbolistik 2025/2026, duke shtuar cilësi dhe përvojë në repartin defensiv. Bëhet fjalë për mbrojtësin e djathtë nga Bosnjë-Hercegovina, Enedin Mulaliq. "KF Llapi ka kënaqësinë t'ju prezantojë Enedin Mulaliq si përforcimin më të ri të skuadrës sonë. 21-vjeçari nga Bosnjë-Hercegovina ka nënshkruar kontratë trevjeçare me bardhekaltrit dhe tashmë i është bashkuar ekipit në fazën përgatitore para sezonit të ri", thuhet në njoftimin zyrtar të klubit

llapjan. Mulaliq luan në pozitën e mbrojtësit të djathtë dhe është rritur si futbollist në akademinë e njohur të FK Sarajevo, duke kaluar me sukses të gjitha grupmoshat deri te skuadra seniore. Më pas ai ka veshur fanellat e FK Sloboda Tuzla dhe, së fundmi, të HSK Posušje, duke grumbulluar përvojë të rëndësishme në futbollin boshnjak. "Ky transferim i rëndësishëm është finalizuar falë bashkëpunimit të ngushtë mes klubit dhe përfaqësuesve të lojtarit, Jusuf Çizmiç dhe Anis Bujak, të cilët i falënderojmë për angazhimin dhe kontributin e dhënë në realizimin e këtij transferimi. Besojmë se Enedin Mulaliq do të jetë një element

kyç në përmbushjen e objektivave tona për sezonin e ardhshëm", thuhet më tej në komunikatën e klubit. Me këtë përforcim Llapi synon ta forcojë më tej mbrojtjen dhe ta shtojë konkurrencën brenda skuadrës në përpjekje për t'i arritur objektivat e klubit.

Batatina thumbon Malishevën pas humbjes 8-0: Në Evropë s'ka aleanca

Trajneri i Llapit, Tahir Batatina, e ka thumbuar Malishevën pas humbjes turpëruese nga Vikinguri prej 8-0. Batatina ka thënë se në ndeshjet në Evropë nuk ka aleanca e që, sipas tij, atje luhen ndeshje të vërteta



futbolli. "Merr edhe 8 gola dhe turpërohesh nga skuadra që në vlerë është e barabartë me klubet tona. Ata nuk bëjnë aleanca, por luajnë futboll", ka shkruar Batatina. Në të dy

ndeshjet parakualifikuese për Ligën e Konferencës, Malisheva i pranoi nëntë gola nga Vikinguri, duke u bërë skuadra nga Kosova me humbjen më të thellë në garat evropiane.

BERISHA: SHUMË SHPEJT JU NJOFTOJ PËR SKUADRËN E RE

PRISHTINË, 18 KORRIK - Futbollisti i Kosovës, Bernard Berisha, të enjten është larguar nga Akhmat. Futbollisti pejan ishte transferuar në skuadrën çeçene në vitin 2017. Berisha kishte synuar ta mbyllte karrierën në këtë skuadër, por futbolli është i tillë, dhe kjo ëndërr i mbeti e parealizuar. "Po largohem nga Grozni me zemër të plotë - plot krenari, mirënjohje dhe kujtime të pashlyeshme. Edhe pse nuk do të vesh më këtë bluzë në fushë, Akhmati do të jetë gjithmonë pjesë e imja dhe do të mbajë një vend të veçantë në zemrën time. Do të shihemi përsëri, inshallah! Akhmati do të jetë gjithmonë shtëpia ime dhe e familjes sime, me kujtimet më të çmuara", ka thënë Berisha.



Ish-futbollisti i Besës së Pejës të premten ka njoftuar se shumë shpejt do të vendosë për të ardhmen. "Përshëndetje të gjithëve! Nga sot jam lojtar i lirë. Pas përfundimit të marrëveshjes me Akhmat, shumë shpejt do t'ju njoftoj për klubin e ri", ka deklaruar Berisha.

FITORE E THELLË E KOSOVËS NDAJ IZRAELIT

PRISHTINË, 18 KORRIK - Përfaqësuesja U19 e Kosovës në hendboll e ka fituar me rezultat të thellë ndeshjen e parë për plasman në Kampionatin Evropian në Gjeorgji. Të premten paradite në Telavi vashat "dardane" shkëlqyen dhe triumfuan me rezultatin 35:26 ndaj Izraelit. Që në nismë, vajzat e Kosovës shfaqën cilësi dhe krijuan epërsi bindëse prej 5:0 e 11:1, më pas e kontrolluan rezultatin deri në fund. Pjesa e parë përfundoi 17:10. Martina Bibaj udhëhoqi Kosovën me dhjetë gola nga 12 tentime. Diona Dresh i kishte shtatë gola nga nëntë tentime, ndërsa Arjeta Imeraj i realizoi gjashtë gola nga shtatë tentime. Me nga tri gola ndeshjen e përfunduan Sara Gjergjaj e Zoja Kameraj, nga dy i shënuan Orgesa



Gola e Elona Zeneli, kurse nga një Klaudia Ukaj e Arona Krasniqi. Portierja Donjeta Shabani u dallua me 13 pritje dhe u shpall më e mira e ndeshjes. Të gjitha lojtaret dhanë kontribut në fitoren e rëndësishme. Tani Kosova U19 luan për vendin e pestë në Evropianin B në Gjeorgji. Ndeshja për vend të pestë është të dielën.

Lëndimi i Emërllahut nuk është serioz

CLUJ-NAPOCA, 18 KORRIK - Mesfushori Lindon Emërllahu pësoi një lëndim në ndeshjen e CFR Cluj ndaj Paks në kuadër të kualifikueseve për Ligën e Evropës. CFR Cluj fitoi me rezultat 3-0 ndaj Paksin në ndeshjen kthyesë të raundit të parë të Ligës së Evropës, duke

siguruar kualifikimin në raundin pasues. Meriton Korenica ishte një nga më meritoret për këtë kualifikim të rumunëve, pasi bëri dy asistime për bashkëlojtarët e tij. Në këtë ndeshje Emërllahu ishte i pafat këtë ndeshje duke u detyruar të largohet në fillim

me lot në sy. Sipas medieve rumune, dëmtimi i Emërllahut nuk është serioz dhe ai do të kthehet brenda dy javësh. "CFR pati dy lojtarë të lënduar në 18 minutat e para të ndeshjes me Paksin. Kosovari Emërllahu ishte i pari që u lëndua. Sa i përket mesfushorit

qendror nga Kombëtarja e Kosovës, dëmtimi nuk është aq serioz. Emerllahu ka një problem muskulator dhe mund të rikuperohet deri në ndeshjen e kthimit me Luganon, nga raundi i dytë i Ligës së Evropës", shkruan prosport.ro.



Jashari, presion Club Brugges për transferimin në Milan

MILANO, 18 KORRIK - “La Gazzetta dello Sport” raporton se Ardon Jashari nuk pozoj me shokët e ekipit Club Brugge për një foto ekipoze të enjten, ndërsa vazhdon të shtyjë për një transferim në Milan. Talenti i Club Brugges, Jashari, thuhet se po shtyn përpara për një transferim te Milani

këtë verë dhe nuk mori pjesë në foton zyrtare të ekipit. Gazeta këmbëngul se mesfushori zviceran dëshiron të transferohet në “San Siro” vetëm në merkaton e verës 2025, por klubi i tij ende nuk e ka pranuar propozimin e fundit të Milanit me vlerë 32.5 milionë euro plus 2 milionë

euro bonuse. Jashari rifilloi stërvitjen me pjesën tjetër të ekipit në fillim të kësaj jave, por po bëhet gjithnjë e më i pakënaqur në Brugge, duke pasur parasysh se dëshiron të transferohet në Milano sa më shpejt të jetë e mundur. 22-vjeçari është i vetëdijshëm se nuk do të marrë pjesë në ndeshjet

miqësore parasezonale të Milanit në turneun e tyre në Azi, por shpreson të bashkohet me “rossonerët” në fillim të gushtit. Negociatat midis Milanit dhe Club Brugges janë zvarritur për javë të tëra, kështu që “rossonerët” kanë rinisur bisedimet edhe për mesfushorin e Valencias,



Javi Guerra, i cili shihet si alternativa kryesore ndaj Jasharit.

Drejtori i Leverkusenit: Ka interesim, por dëshirojmë ta mbajmë Xhakën

LEVERKUSEN, 18 QERSHOR - Drejtori sportiv i Bayer Leverkusenit, Simon Rolfes, thekson sërish se nënkampionët e Gjermanisë duan të vazhdojnë të llogarisin tek organizatori i lojës, Granit Xhaka, edhe për sezonin e ri.

Kapiteni 32-vjeçar i Zvicrës është lidhur së fundmi me disa klube, ndërsa interesimi nga Arabia Saudite thuhet se është zbehur, por të saponjiturit në Premierligë, Sunderland, dhe klubi i Mourinhos, Fenerbahçe, vazhdojnë të tregojnë interes për mesfushorin. Por Simon Rolfes ka folur qartë për këtë çështje. “Graniti është një lojtar shumë i rëndësishëm për ne – për skuadrën dhe për klubin. Interesimi ynë kryesor është ta mbajmë”, ka thënë drejtuesi i Leverkusenit në një konferencë për shtyp në Rio de Janeiro, ku skuadra ndodhet aktualisht në



një kamp stërvitor. “Sigurisht që ka interesim për të. Duhet të flasim me lojtarin për të ditur cilat janë ambiciet e tij. Por, është e qartë: vetëm nëse do të jetë një situatë ‘fitim-fitim’ do të ketë një transferim”, ka shtuar Rolfes. “Kemi edhe tre vjet kontratë me lojtarin dhe jemi shumë të kënaqur me të. Kemi

objektiva të mëdha për vitet në vijim. Prandaj, një transferim mund të ndodhë vetëm nëse është në të mirë të të gjitha palëve. Duhet të presim, por synimi ynë është që Graniti të qëndrojë me ne”, ka deklaruar ai. Vetë Xhaka deri tani nuk është shprehur publikisht për qëllimet dhe planet e tij.

Marseille i shtohet garës për transferimin e Zhegrovës

Marseille, 18 korrik - Olympique Marseille është skuadra më e fundit që ka shprehur interesim për reprezentuesin e Kosovës, Edon Zhegrova, raportojnë mediet në Francë. Ylli “dardan” e nisi sezonin mirë, por më pas pësoi një lëndim që e la jashtë fushës për të gjithë gjysmën e dytë të edicionit 2024/25. Përveç gjendjes së tij fizike, karakteri i tij ngre dyshime, sipas analistit të “RMC”, Kevin Diaz, i cili e sheh këtë transferim si shumë të rrezikshëm dhe të komplikuar, duke e përshkruar 26-vjeçarin si një person të vështirë për t'u menaxhuar. “Ai është një person i vështirë. Ka shumë vështirësi në menaxhim”, ka thënë Diaz. Sipas tij, paqëndrueshmëria emocionale e Zhegrovës mund të përbëjë një pengesë serioze për integrimin e tij në Marseille. “Edon Zhegrova ka një potencial të jashtëzakonshëm, por transferimi i tij te Marseille duket shumë i rrezikshëm. Temperamenti i tij i



vështirë dhe mungesa e pjekurisë mund ta dëmtojnë harmoninë e ekipit. Nëse ai nuk ndryshon rrënjësisht, ky transferim mund të shmanget nga Marseille”, shkruan mediumi francez “Score”. Lille e vlerëson ish-futbollistin e Baselit në 20 milionë euro, ndërsa ai ka kontratë me klubin francez edhe për një vit. Sipas Transfermarkt, vlera e tregut të Zhegrovës është 25 milionë euro. Për të kanë treguar

interesim edhe skuadrat Nottingham Forest, Newcastle United, Napoli, Milani, Atalanta dhe Fenerbahçe. Për shkak të lëndimit, Zhegrova nuk ka luajtur që nga 14 dhjetori, gjë që ka shqetësuar klubet e interesuara dhe disa prej tyre po heqin dorë gradualisht. Prishtinasi kishte zhvilluar 21 ndeshje në pjesën e parë të sezonit, duke shënuar 8 gola dhe dhënë 2 asistime.

SHKURT

Art Smakaj transferohet në Austri te LASK-u

Klubi austriak LASK nga Linzi ka konfirmuar zyrtarisht transferimin e reprezentuesit të Kosovës, Art Smakaj nga Lokomotiva Zagrebi. Smakaj ka bërë një hap tutje në karrierë duke kompletuar transferimin nga futbolli kroat tek ai austriak. Është vetë faqja zyrtare e klubit LASK e cila ka konfirmuar transferimin e Smakajt, i cili thuhet se i ka kushtuar 700 mijë euro. “Reprezentuesi i Kosovës, Art Smakaj, do të luajë për LASK-un në të ardhmen. Mesfushori 22-vjeçar po transferohet nga klubi i divizionit të parë kroat Lokomotiva Zagreb te Linz dhe ka nënshkruar një kontratë deri në verën e vitit 2028”, thuhet në njoftimin e LASK-ut. Smakaj ishte një lojtar i padiskutueshëm titullar në Zagreb sezonin e kaluar, duke luajtur 32 nga 36 ndeshjet në Superligën e Kroacisë, duke luajtur titullar çdoherë. 22-vjeçari, i cili mund të luajë si në mesfushë mbrojtëse ashtu edhe në qendër të mbrojtjes, shënoi dy gola dhe dha pesë asistime. Te LASK-u, Smakaj do ta takojë bashkëlojtarin nga Kombëtarja e Kosovës, Valon Berishën.

Liverpooli e përjetëson Diogo Jotën: Ai do të jetë gjithmonë numri ynë 20

Liverpooli ka shtuar një seksion të ri në faqen zyrtare të internetit si homazh për Diogo Jotën pas vdekjes së tij të parakohshme. Më 3 korrik Jota dhe vëllai i tij, Andre Silva, humbën jetën kur makina e tyre u aksidentua në orët e para të mëngjesit në veri të Spanjës. Pas ngjarjes tragjike, Liverpooli njoftoi se fanella me numrin 20 e Jotës do të tërhiqej menjëherë nga të gjitha nivelet, pas konsultimit me bashkëshorten e tij dhe familjen. Që nga ajo kohë klubi ka zgjeruar homazhin edhe në faqen zyrtare. Në seksionin e faqes ku renditet skuadra e parë e meshkujve sipas pozicioneve, një link për profilin e Jotës është përjetësuar nëntitulli “përgjithmonë”. Profili i Jotës tani përmban një homazh për sulmuesin, i cili mbyllet me fjalinë: “Ai do të jetë gjithmonë numri ynë 20”.

Atalanta refuzon ofertën e parë për Lookman, Interi nuk dorëzohet

Atalanta ka refuzuar ofertën e parë prej 40 milionë eurosh nga Interi për sulmuesin nigerian Ademola Lookman, por kjo nuk i ka dekurajuar drejtuesit zikaltër, Giuseppe Marotta dhe Piero Ausilio. Objektivi i Interit është i qartë: ta transferojë 26-vjeçarin në Milano. Interi ka arritur një marrëveshje personale me futbollistin për një kontratë pesëvjeçare me pagë 4 milionë euro në sezon, Atalanta kërkon të përfitojë sa më shumë nga shitja. Çmimi është vendosur në 50 milionë euro dhe shpresa e bergamaskëve është që Atletico Madridi të rihyjë në garë për të krijuar një ankand mes klubeve të interesuara.

Arabia Saudite i ofron Viniciusit kontratë marramendëse prej 1 miliard eurosh

Klube të fuqishme saudite po përpiqen ta tundojnë yllin e Real Madridit, Vinicius Junior, me një ofertë që ka tronditur botën e futbollit. Sipas “Give Me Sport”, sulmuesit

brazilian i është ofruar një kontratë pesëvjeçare me një pagë neto totale prej një miliard eurosh. Oferta e jashtëzakonshme do ta bënte Viniciusin një nga lojtarët më

të paguar në historinë e sportit, duke tejkaluar shifrat rekord që janë parë deri më sot në Arabinë Saudite për yje si Cristiano Ronaldo, Karim Benzema apo Neymar. Ky

propozim vjen në një moment kur Viniciusi është një nga figurat më të rëndësishme të Real Madridit. Megjithatë, mbetet të shihet nëse brazilianin do

të tundojë pasuria saudite apo do të zgjedhë ta vazhdojë rrugëtimin në “Santiago Bernabeu” dhe të ndërtojë një trashëgimi të madhe me “Los Blancos”.



1302/25
18.07.2025

Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017 dhe nenit 18 dhe nenin 22 të Rregullores Nr. 13/25 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të miratuar me datë 26.02.2025 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L “Përparimi” Sh. A, e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit **1301/25** të datës **18.07.2025** të **Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L “Përparimi” Sh. A**, me datë **18.07.2025** shpall:

KONKURS PUBLIK

- I. Titulli:** Shofer i Kamionit
Numri i ekzekutuesve: 1
Orët e punës: 40 orë në javë
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar gjashtë (6) muaj nga të cilat tre (3) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.
Përgatitja profesionale: Shkolla e mesme
Përvoja e punës: Preferohet gjashtë (6) muaj
I raporton: Menaxherit të Njesisë për Mbledhjen dhe Transportimin e Mbeturinave
Koeficienti i pagës: 504.18 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Kujdeset për mirëmbajtjen e automjetit transportues, larjen, lercjen, evidentimin e prishjeve etj.
- Drejton dhe mirëmban sipas nevojës edhe automjetet tjera të ndërmarrjes.
- Në fletudhëtim regjistron numrin e kilometrave të kaluara dhe shënimet tjera, të cilat kërkohen.
- Paraqet çdo defekt dhe dëmtim të shkaktuar në automjet dhe bën arsyetimin e shpenzimeve të derivateve dhe kilometrave të kaluara.
- Me rastin e prishjes së automjetit vozitësi është i obliguar të benë ndreqje të vogla, si ndërrimin e gomës, pastrimin e filterit etj, të qëndrojë pranë automjetit në punëtori dhe t'i ndihmojë mekanikut ose gomistit.
- Çdo mëngjes është i obliguar të kontrollojë sasinë e vajit, ujit dhe gjendjen e gomave në automjet.
- Është i obliguar që për prishjet në automjet me kohë të lajmëroi kryepunëtorin e vet drejtpërdrejt.
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhrave të Menaxhmentit të Ndërmarrjes.
- Për punën e tij i përgjigjet Menaxherit të Njesisë së Mbledhjes dhe Transportimin e mbeturinave.

Kusht i posaçëm:

- Kategoria C e vozitjes.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L “Përparimi” Sh. A - Vushtri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmia se ka patentën e shoferit të kategorisë C (e skanuar);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojnë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

Periodha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data **21.07.2025** deri me datë **04.08.2025** në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë **11.08.2025**.
- Afati për ankesë nga data **12.08.2025** deri me datë **14.08.2025**.
- Periodha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë **28.08.2025**.
- Afati për ankesë nga data **29.08.2025** deri me datë **02.09.2025**.
- Periodha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë **09.09.2025**.
- Afati për ankesë nga data **10.09.2025** deri me datë **12.09.2025**.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu **19.09.2025**.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

Dokumentet që kërkohet para themelimit të marrëdhënies së punës:

- Vërtetimi për zotësinë e plotë të veprimit.
- Certifikatën shëndetësore.

Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L “Përparimi” Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do tu asistoj dhe tu jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim:
hrperparimi@gmail.com.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik, dhe secili nga kandidatët do të njoftohet individualisht.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

Sqarim

Ndërmarrja ka për qëllim të sqarojë çështjen e termeve të përdorura në aspektin gjinor, meqë rast fjalët dhe titujt e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.

Përfundim

N.P.L “Përparimi” Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.



1302/25
18.07.2025

U skladu sa članom 8, članom 10, stavom 2.2 i članom 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljenog u Službenom listu Republike Kosovo dana 01.12.2010. godine, u vezi sa članom 7 Administrativnog uputstva MFPT - br. 01/2024 o regulisanju postupaka konkurencije u javnom sektoru koje je dio Zakona br. 03/L-212 o radu koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo dana 31.10.2017. godine i članom 18 i članom 22 Uredbe br. 13/25 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mjesta koju je 26.02.2025. godine odobrio Upravni odbor NPL “Përparimi” Sh. A, a na osnovu odluke br. Protokola 1301/25 od 18.07.2025. godine, Glavnog izvršnog direktora, NPL “Përparimi” Sh. A, od 18.07.2025 godine, objavljuje:

JAVNI KONKURS

- I. **Naslov:** Vozač kamiona
Broj dželata: 1
Radno vrijeme: 40 sati sedmično
Trajanje termina: Na određeno vrijeme od šest (6) mjeseci, od kojih će tri (3) mjeseca biti probni rad, s mogućnošću produženja.
Profesionalna priprema: Srednja škola
Radno iskustvo: Poželjno šest (6) mjeseci
Izvjestava se: Rukovodilac Jedinice za sakupljanje i transport otpada
Koeficijent plate: 504,18 Euro Bruto

Opis poslova i odgovornosti:

- Brinc se o održavanju transportnog vozila, pranju, farbanju, evidentiranju kvarova itd.
- Vozi i održava druga službena vozila po potrebi.
- U dnevnik putovanja zabilježite broj pređenih kilometara i ostale potrebne bilješke.
- U njemu se prikazuju svi nedostaci i oštećenja na vozilu i opravdava troškovi goriva i pređeni kilometri.
- U slučaju kvara vozila, vozač je dužan izvršiti manje popravke, poput zamjene gume, čišćenja filtera itd., ostati pored vozila u radionici i pomoći mehaničaru ili vulkanizeru.
- Svako jutro je obavezan provjeriti količinu ulja, vode i stanje guma u vozilu.
- On je dužan da odmah direktno obavijesti svog nadređenog o svim kvarovima na vozilu.
- Također obavlja i druge zadatke po nalogu Uprave preduzeća.
- Za svoj rad odgovara šefu Jedinice za sakupljanje i transport otpada.

Poseban uslov:

- Vozačka kategorija C.

Uz prijavu je potrebno priložiti sljedeće:

- Obrazac prijave za NPL “Përparimi” Sh. A - Vučitrn;
- Dokaz o obrazovnim kvalifikacijama (skeniran);
- Izvod iz matične knjige rođenih; (prihvatit će se izvod izdat online na platformi e-Kosova);
- Dokaz o posjedovanju vozačke dozvole C kategorije (skeniran);
- Potvrda o krivičnoj osudi izdata od strane Sudskog vijeća Kosova, kojom se potvrđuje da nema krivičnih osuda u centralnoj krivičnoj evidenciji Republike Kosovo (potvrde izdate online na platformi e-Kosova će biti prihvaćene);
- Dokaz o radnom iskustvu (skeniran) (nije obavezan);
- Kopija lične karte (skenirana);

Opći kriteriji koje svi kandidati moraju ispunjavati.

- Budite državljanin Republike Kosovo.
- Da ima punu sposobnost djelovanja.
- Da vlada barem jednim od službenih jezika u skladu sa Zakonom o jezicima.

Metoda ocjenjivanja kandidata.

- Pismeni test do sedamdeset (70) bodova.
- Usmeni intervju do dvadeset (20) bodova
- CV kandidata treba da sadrži do deset (10) bodova.

Period za prijavu kandidata i približan kalendar postupka zapošljavanja.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja. Objava je otvorena od 21.07.2025. do 04.08.2025. u 16:00 sati.

Približan kalendar postupka zapošljavanja:

- Preliminarna provjera prijava kandidata najkasnije do **11.08.2025.**
- Rok za žalbu je od **12.08.2025** do **14.08.2025.**
- Rok za polaganje pismenog testa i ocjenjivanje kandidata je najkasnije do **28.08.2025.**
- Rok za žalbu je od **29.08.2025** do **02.09.2025.**
- Rok za usmeni intervju i ocjenjivanje kandidata je najkasnije do **09.09.2025.**
- Rok za žalbu je od **10.09.2025** do **12.09.2025.**
- Objavljivanje konačnih rezultata u vezi s uspješnim kandidatom je najkasnije do **19.09.2025.**

Približan vremenski okvir postupka zapošljavanja može biti duži ili kraći, ovisno o tome da li je podnesena žalba ili ne, te ovisno o radu komisije za ocjenjivanje i kadrovske službe. U svim slučajevima kada se žalba podnese u bilo kojoj fazi postupka zapošljavanja, žalba će imati suspenzivno dejstvo dok je ne razmotri Komisija za žalbe.

Dokumenti potrebni prije zasnivanja radnog odnosa:

- Dokaz o punoj poslovnoj sposobnosti.
- Zdravstveni certifikat.

Kako se prijaviti i komunicirati s kandidatima

Zainteresovani kandidati mogu preuzeti prijavni obrazac u Arhivi NPL “Përparimi” SH. A u gradu Vučitrnu, ulica “Gjergj Kastriot Skënderbeu” br. 82, (bivši objekat KPC u blizini Osnovnog suda u Mitrovici - ogranak u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 sati. Kadrovska služba, primjenjujući član 8. stav 3. Uputstva MFPT-br. 01/2024 o regulisanju konkursnih postupaka u javnom sektoru, pružit će potrebna pojašnjenja kandidatima u vezi s kriterijima javnog konkursa, te će pomoći i pružiti potrebna uputstva za prijavu putem e-pošte.

Podnošenje prijave sa svom potrebnom dokumentacijom u ovom javnom oglasu mora se izvršiti isključivo putem sljedeće elektronske adrese: hrperparimi@gmail.com.

Sva komunikacija tokom postupka javnog konkursa odvijat će se putem elektronske komunikacije, a svaki kandidat će biti pojedinačno obavješten.

Napomena: Prijave podnesene nakon isteka roka neće biti prihvaćene.

POJAŠNENJE

Cilj ovog poduhvata je razjasniti pitanje termina koji se koriste u smislu roda, budući da riječi i nazivi jednog roda uključuju i drugi rod.

ZAKLJUČAK

NPL “Përparimi” D.A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Republike Kosovo, a podstiču se da se prijave i pripadnici manjinskih zajednica i njihovi pripadnici, osobe sa invaliditetom i nedovoljno zastupljeni spol.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Rron Caffë” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811309071 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Rron Caffë” D.O.O. od Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811309071 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Rron Caffë” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811309071 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Burim Grezda shpall të pavlefshme diplomën e shkollë së mesme teknike “Nexhmedin Nixha”, Gjakovë.

- Elona Gjocaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollë së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi”, dhe certifikatën e maturës.

- ARBNORA HALITI, shpall te pavlefshme diplomën e SHMLM “Dr. Xheladin Deda”.

- LEUTRIM ZYMERI, shpall te pavlefshme certifikatën e testit te maturës te SHMLM “Dr. Xheladin Deda”.

- ERMIRA MURSELI, shpall te pavlefshme certifikatën e testit te maturës te SHMLM “Dr. Xheladin Deda”.

- SPASENA RADOSAVLJEVIC B.I, shpall të humbur certifikatën e biznesit me numër unik identifikues: 810698631.

- Endrit Cena nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M.M. “Hysni Zajmi”, Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, bane-sa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjbiznesi.com,

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878 info@kolegjbiznesi.com

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë dhe Dega në Prizren:

Kolegji Biznesi shpall konkursin publik të rregullt për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2025/2026, në të gjitha programet e studimit të akredituara nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës dhe të licencuara nga MASHT.

Të drejtë aplikimi dhe regjistrimi në studimet themelore (Bachelor) e kanë të gjithë kandidatët që e kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë dhe që e kanë përfunduar me sukses testin kombëtar të maturës. Kurse ne studimet Master kanë të drejtë aplikimi dhe regjistrimi të gjithë kandidatët që i kanë përfunduar Studimet Bachelor.

- | | |
|--|---|
| Studime Bachelor | Studime Master |
| 1.Banka dhe Financa në Biznes (Ba) - (3 Vjeçar) | 1.Menaxhment dhe Financa – MA-(2 Vjeçar) |
| 2.Menaxhment dhe Ekonomiks (Ba) - (3 Vjeçar) | 2.Menaxhimi i Emergjencave – MA-(2 Vjeçar) |
| 3.Menaxhimi i Emergjencave (Ba) - (3 Vjeçar) | |
| 4.Juridik / LLB - (4 Vjeçar) | |
| 5. Shkenca Kompjuterike Bsc - (3 Vjeçar) | |

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Bachelor, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Certifikata e maturës shtetërore – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Diploma e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Dëftesat e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Ekstrakti i lindjes;
- Kopje e letërnjoftimit;
- 2 fotografi (formati pasaportë)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Master, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të noterizuar)
- CV
- Certifikatën e lindjes
- Kopjen e letërnjoftimit
- Dy foto

038/045- 500 878 : 029-230-555
044/ 049/ 048- 500 – 878



Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë –

Kosovë, www.kolegjbiznesi.com, info@kolegjbiznesi.com

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: **30.05.2025**, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë:

SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK

I. PROFESORA

1. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Ekonomik,**
2. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Juridik,**
3. **Dy (2)** mësimdhënës në programin - **Menaxhimi i Emergjencave,**
4. **Një (1)** mësimdhënës në programin – **Shkenca Kompjuterike,**

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Kolegjit Biznesi.

Për vendin e punës mësimdhënës, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatëse dhe punime në revistat si SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE.

Njohja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar (vërtetuar), Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.

Kandidatët që kanë doktoruar jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga **18.06.2025 deri më 30.06.2025.**

Paraqitja e dokumenteve: Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, 10000 Prishtinë, Kosovë ose përmes e-mail: info@kolegjbiznesi.com

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: www.kolegjbiznesi.com

Aplikacionin mund ta shkarkoni në ueb faqen: www.kolegjbiznesi.com ose mund ta merrni në zyrat e Kolegjit Biznesi.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

